

Në bazë të nenit 38 paragrafi 1, pika 1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Malit të Zi", numër 02/18 dhe 34/19), Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më 28.10.2019, miratoi

STATUTIN E KOMUNËS SË ULQINIT

I - DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Me Statutin e Komunës së Ulqinit (në tekstin në vazhdim: Statutin) rregullohen të drejtat dhe obligimet e Komunës dhe mënyra e realizimit të tyre, punët dhe mënyra e vendimmarrjes së popullatës lokale, mënyra dhe kushtet e kryerjes së punëve vetanake, financimi, mënyra dhe procedura e zgjedhjes dhe shkarkimit të kryetarit të Kuvendit dhe kryetarit të Komunës, nënkryetarit të Kuvendit dhe nënkryetarit të Komunës, mënyra dhe procedura e shkarkimit të sekretarit të Kuvendit, organizimi dhe mënyra e punës të administratës lokale, mënyra dhe procedura e shkarkimit të kryeadministratorit, funksionarëve të organeve të administratës lokale, ndihmës funksionarëve të organeve, arkitektit kryesor të qytetit dhe menaxherit të Komunës, mënyra e ushtrimit të mbikëqyrjes së punës së organeve të administratës lokale, shërbimeve profesionale dhe të posaçme (në tekstin e mëtejme: organet e administratës lokale), mënyra e nxjerrjes së dispozitave, mënyra e sigurimit të transparencës së punës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në kryerjen e punëve nga kompetencat e Komunës, forma dhe përmbajtja e simboleve, festa e Komunës dhe mënyra e shënimit të saj, themelimi dhe puna e bashkësisë lokale (vendore) dhe formave të tjera të vetëqeverisjes lokale, pjesëmarrja e qytetarëve në realizimin e vetëqeverisjes lokale, kushtet për nisjen e iniciativës qytetare dhe çështje të tjera me rëndësi për funksionimin e vetëqeverisjes lokale.

Neni 2

Shprehjet e përdorura në këtë Statut për personat fizikë të gjinisë mashkullore, nënkuptojnë të njëjtat shprehje edhe për gjininë femërore.

Neni 3

Në Komunë kryhen punë me interes të drejtpërdrejtë dhe të përbashkët për popullatën lokale.

Në kryerjen e punëve Komuna është e pavarur, kurse të drejtat e saja mund të kufizohen vetëm në rastet dhe kushtet e përcaktuara me ligj, në pajtim me Kushtetutën.

Neni 4

Komuna është njësi e pavarur territoriale në të cilën qytetarët realizojnë vetëqeverisjen lokale në pajtim me ligjin, Statutin, si dhe Kartën Evropiane të vetëqeverisjes lokale.

Territori i Komunës së Ulqinit është përcaktuar me ligj dhe përbëhet nga qyteti i Ulqinit dhe vendbanimet si në vijim: Amull, Mali i Bardhë, Braticë, Mali i Brisë, Bojk, Brajshë, Katërkollë, Shtoji i Naltë, Killezna Naltë, Shtoji Poshtë, Killezna Poshtë, Darzë, Draginë, Gjeranë, Zhej, Zogaj, Krythë e Ulqinit, Krythë, Krruç, Kollomzë, Kodra, Kosiq, Kaliman, Kravar, Leskoc, Lisna Borë, Millë, Megjureç, Pistull, Reç, Rashtishë, Sukubinë, Sumë, Salç, Sutjel, Shëngjergj, Qyrkaj, Fraskanjel, Shas, Shtodër, Selitë, Rashtishë e Poshtme, Gjonza, Kravari i Poshtëm dhe vendbanime tjera të përcaktuara me vendim të posaçëm të Kuvendit.

Territori dhe emri i Komunës mund të ndryshohen sipas procedurës së paraparë me ligj.

Neni 5

Kufijtë territorial të vendbanimeve përcaktohen me vendim të Kuvendit të Komunës. Vendimin për bashkimin, ndarjen ose anulimin e vendbanimeve e nxjerr Kuvendi i Komunës.

Emrin dhe ndryshimin e emrit të vendbanimit, rrugëve dhe shesheve e përcakton Kuvendi i Komunës, me mendimin e organit kompetent të vetëqeverisjes vendore në territorin e të cilit gjendet vendbanimi, rruga, përkatësisht sheshi.

Neni 6

Komuna ka statusin e personit juridik me të drejtat dhe obligimet e përcaktuara me Kushtetutë, ligj dhe këtë Statut.

Selia e Komunës është në bulevardin "Gjergj Kastrioti Skënderbeu pa numër, Ulqin. Komunën e prezanton dhe përfaqëson Kryetari i Komunës.

Neni 7

Komuna ka emblemën dhe flamurin.

Emblema e Komunës së Ulqinit ka formën e mburojës në të cilën figurativisht janë të komponuara të gjitha simbolet karakteristike për qytetin e Ulqinit: Kalaja me gurë në themele në bregun e detit, simboli i diellit i vendosur mbi Kala, dega e ullirit me fruta, barka e lashtë llire me kokë ujku të kthyer kah barka, kurse emblema ka skaje të arta.

Flamuri i Komunës është i bardhë, me stemën e Komunës në mes.

Përdorimi i simboleve të Komunës rregullohet me vendim të Kuvendit të Komunës.

Neni 8

Komuna ka festën e vet.

Festa e Komunës është e shtuna e parë në muajin prill.

Festa e Komunës simbolizon përfundimin e mbledhjes së ullinjve, daljen e detarëve në det dhe fillimin e sezonit turistik.

Festa e Komunës shënohet me organizimin e Mbledhjes solemne të Kuvendit të Komunës dhe forma të tjera të solemniteteve të përcaktuara me Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Vendim të Kuvendit të Komunës.

Në Komunën e Ulqinit festohen dhe shënohen edhe data të tjera karakteri i të cilave promovon harmonin multikulturore dhe multinacionale e që do të përcaktohen me një vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës.

Neni 9

Komuna, organet e saja dhe organet e administratës lokale kanë vulën.

Vula e Komunës është e rrumbullakët me diametër 32 mm dhe përmban: "Crna Gora - Mali i Zi, Opština Ulcinj - Komuna e Ulqinit, Ulcinj - Ulqin".

Në mes të vulës është emblema e Komunës.

Vula e organeve të Komunës dhe organeve të administratës lokale, krahas elementeve nga paragrafi 2 të këtij neni përmban edhe emrin e organit dhe shkruhet në gjuhën zyrtare dhe gjuhën shqipe.

Kuvendi i Komunës me vendim të posaçëm rregullon: punimin, përdorimin, ruajtjen dhe asgjësimin e vulës dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me përdorimin e vulës.

Përdorimi i gjuhës dhe shkrimit

Neni 10

Në Komunën e Ulqinit në përdorim zyrtar janë të barabarta gjuha malazeze dhe gjuha shqipe si dhe shkrimi (alfabeti) i tyre.

Neni 11

Organet e Komunës, organet e administratës lokale, institucionet publike dhe sipërmarrjet themelues i të cilave është Komuna, janë të detyruar që të sigurojnë shfrytëzimin e gjuhës dhe shkrimit të tyre nga neni paraprak në procedurën administrative dhe gjyqësore, me rastin e lëshimit të dokumenteve publike dhe udhëheqjes së evidencës zyrtare, të gjitha akteve lidhur me të drejtën zgjedhore, shprehjen, ruajtjen, kultivimin, zhvillimin dhe manifestimin publik të përkatësisë kombëtare, etnike, kulturore dhe fetare në pajtim me Ligjin.

Emrat e organeve të cilët ushtrojnë autorizime publike, emri i komunës, emrat e vendbanimeve, shesheve, rrugëve, institucioneve, bizneseve, kompanive të tjera dhe toponimeve shkruhen edhe në gjuhën dhe shkrimin (alfabetin) nga neni 10 i këtij Statuti.

Barazia e gjuhës malazeze dhe shqipe dhe shkrimit (alfabetit) të tyre në jetën publike sigurohet në komunikim me institucionet publike, shkollat, sipërmarrjet dhe të gjitha subjektet të cilat kryejnë autorizime publike dhe në të gjitha fushat e jetës publike (mbledhjet e qytetarëve, tubimet, manifestimet etj.).

Neni 12

Në Kuvendin e Komunës këshilltarit pjesëtar të pakicës kombëtare i sigurohet edhe përdorimi i gjuhës dhe shkrimit të tij në pajtim me këtë Statut dhe me ligj.

Neni 13

Draft aktet nxirren në shqyrtim publik në gjuhën zyrtare malazeze dhe në gjuhën dhe shkrimin shqip.

Diskutimi për aktet nga paragrafi paraprak bëhet në ato gjuhë.

Neni 14

Aktet e përgjithshme të cilat i nxjerrin organet e Komunës shkruhen dhe publikohen në gjuhën zyrtare dhe gjuhën shqipe.

Të drejtat dhe liritë e popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera kombëtare

Neni 15

Në Komunën e Ulqinit popujt pakicë dhe komunitetet e tjera kombëtare kanë të drejtë në përfaqësim proporcional në organet e vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjet publike, institucionet dhe institucionet themelues i të cilave është Komuna.

Për përfaqësimin e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera kombëtare kujdeset kryetari i Komunës.

Popujt pakicë dhe komunitetet e tjera kombëtare që janë pakicë dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë të themelojnë dhe të mbajnë raporte të lira dhe paqësore përtej kufirit me shtetet e tyre amë dhe bashkëkombësit të cilët jetojnë në vendet e tjera, posaçërisht me ata me të cilët kanë identitet të përbashkët etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar.

E drejta nga paragrafi 3 i këtij neni nuk mund të realizohet në kundërshtim me interesat e Malit të Zi.

Neni 16

Komuna siguron mbrojtjen e të drejtave të pakicave në pajtim me mbrojtjen juridike ndërkombëtare dhe dispozitat vendore.

Neni 17

Me qëllim të ruajtjes, zhvillimit, avancimit dhe shprehjes së identitetit kombëtar e kulturor, pjesëtarët e pakicave kombëtare në Komunën e Ulqinit mund të themelojnë shoqata, organizata joqeveritare dhe fondacione si dhe institucione për ushtrimin e veprimtarisë publike të shfaqjes publike, të veprimtarive kulturore, botuese, muzeale, arkivore, bibliotekare dhe shkencore, si dhe në fusha të tjera të jetës shoqërore.

Komuna e Ulqinit në pajtim me mundësitë e veta financo aktivitetet e institucioneve nga paragrafi 2 i këtij neni.

Neni 18

Pakicat kombëtare kanë të drejtë që lirisht të përdorin shenjat dhe simbolet e pakicave kombëtare dhe lirisht të shënojnë festat e pakicave kombëtare.

Pakicat kombëtare mundën, që krahas përdorimit zyrtar të shenjave dhe simboleve të Malit të Zi, të ngrisin shenjat dhe simbolet përkatëse të pakicave kombëtare të cilat i konfirmon Këshilli i Pakicave Kombëtare dhe përfaqësuesit e pakicave kombëtare themeluar për territorin e Malit të Zi.

Neni 19

Komuna e Ulqinit në harmoni me mundësitë e veta, siguron dhe përkrah veprimtarinë edukative e kulturore të pjesëtarëve të pakicës autoktone vendase shqiptare dhe institucioneve të saja si dhe pakicave të tjera në territorin e saj.

Neni 20

Në ceremonitë zyrtare shtetërore dhe ceremonitë e Komunës së Ulqinit së bashku me flamurin e Malit të Zi ngritet edhe flamuri i popullit autokton (vendës) shqiptar në pajtim me Ligjin.

Shpërblimet dhe mirënjohjet publike

Neni 21

Komuna themelon mirënjohjet publike dhe shpërblimet.

Me qëllim të dhënies së mirënjohjeve për arritje të rëndësishme dhe kontribut me rëndësi të veçantë për zhvillimin dhe reputacionin e Komunës së Ulqinit, e posaçërisht për sukses në fushën ekonomike, shkencës, arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe sportit, si dhe në fusha të tjera të jetës shoqërore dhe krijimtarisë, Komuna e Ulqinit ndanë mirënjohje publike dhe shpërblime.

Neni 22

Mirënjohjet publike dhe shpërblimet e Komunës së Ulqinit janë:

- Qytetar Nderi i Komunës së Ulqinit,
- Mirënjohja e Komunës së Ulqinit për vepër jetësore,
- Shpërblimi vjetor i Komunës së Ulqinit dhe
- shpërblime të tjera.

Neni 23

Qytetar Nderi i Komunës së Ulqinit mund të shpallet shtetasi i Malit të Zi ose shtetasi i huaj i cili me punën e tij shkencore ose veprimtarin politike, ka kontribuar dukshëm në

përparimin dhe prosperitetin e reputacionit të Komunës së Ulqinit, realizimin dhe zhvillimin e demokracisë dhe paqes në Mal të Zi ose prosperitetin e njerëzimit në botë.

Qytetari i Nderit i Komunës së Ulqinit nuk fiton të drejta të posaçme, përkatësisht obligime, kurse mirënjohja mund të revokohet nëse personi tregohet i padenjë për një nder të tillë.

Neni 24

Mirënjohja e Komunës së Ulqinit për vepër jetësore është mirënjohje publike e cila i ndahet personit fizik për arritjet e përgjithshme në përparimin e shkencës, ekonomisë, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, sportit, artit, kulturës, arsimit dhe formave të tjera të jetës shoqërore, që paraqet një kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin dhe reputacionin (famën) e Komunës së Ulqinit.

Neni 25

Shpërblimi vjetor i Komunës së Ulqinit i ndahet personit fizik apo juridik nga vendi apo i huaj për arritjet dhe kontributin në dy vitet e fundit, që kanë rëndësi të veçantë për Komunën e Ulqinit.

Neni 26

Përveç mirënjohjeve publike dhe shpërblimeve nga neni 22 i këtij Statuti, Komuna e Ulqinit ndanë edhe këto shpërblime:

- shpërblime për nxënësit e institucioneve shkollore të arsimit fillor dhe të mesëm për arritje të rëndësishme në garat shtetërore dhe ndërkombëtare, takime dhe revista,
- shpërblime për punëtorët e shëndetësisë dhe arsimit dhe institucionet e përkujdesjes sociale dhe arsimit, për arritje të rëndësishme në ato fusha,
- mentorëve për arritje të rëndësishme të nxënësve në gara, takime dhe revista shtetërore dhe ndërkombëtare,
- shpërblime për sportistë, punëtorë të sportit dhe klubeve për medaljet e fituara në lojërat olimpike, si dhe në kampionatet botërore dhe evropiane, si dhe për arritje të rëndësishme në garat shtetërore dhe ndërkombëtare,
- shpërblime për punëtorët e kulturës dhe atyre që punojnë për përparimin e kulturës në Komunën e Ulqinit dhe
- shpërblime për punëtorët nga fusha e mbrojtjes së rendit publik dhe komunal.

Neni 27

Kushtet, procedura, mënyra e ndarjes së mirënjohjeve publike dhe shpërblime si dhe çështje të tjera, rregullohen me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës.

II – PUNËT E KOMUNËS

Neni 28

Komuna i kryen punët nga kompetencat e saja në pajtim me Ligjin, Statutin dhe dispozitat e Komunës.

Neni 29

Puna e organeve të Komunës, organeve të administratës lokale dhe shërbimeve publike është publike.

Neni 30

Komuna në pajtim me ligjin nxjerr:

- planin strategjik të zhvillimit të Komunës,
- buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit,
- planet dhe programet për lëmi të caktuara,
- projektet urbanistike dhe
- aktet e tjerë në pajtim me kompetencat e veta.

Neni 31

Komuna në pajtim me ligjin dhe dispozitat e tjera:

- rregullon dhe siguron kryerjen dhe zhvillimin e veprimtarive komunale, mirëmbajtjen e objekteve komunale dhe rendit komunal;
- rregullon dhe siguron kryerjen e punimeve të ndërtimit, rindërtimit, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve komunale;
- rregullon dhe siguron transportin e udhëtarëve në trafikun e linjave urbane dhe periferike dhe transportin auto taksi;
- rregullon komunikacionin në territorin e vet, në pajtim me ligjin me të cilin rregullohet siguria e trafikut në rrugë;
- rregullon tokën ndërtimore;
- rregullon dhe siguron kushtet për zhvillimin e sipërmarrjes;
- kujdeset për të mirat lokale me interes të përgjithshëm;
- siguron kushtet dhe kujdeset për mbrojtjen e mjedisit, tokën ujore dhe objektet ujore me rëndësi lokale, kujdeset për mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre, lëshon aktet ujore dhe udhëheqë evidencat e parashikuara, konfirmon zonat erozive, masat kundër erozionit dhe zbaton mbrojtjen nga erozioni dhe vërshimet, organizon dhe siguron kryerjen e punëve të tjera nga fusha e administrimit, shfrytëzimit dhe mbrojtjes së ujërave dhe furnizimit me ujë;
- rregullon marrëdhëniet në fushën e banimit dhe kujdeset për sigurimin e kushteve për mirëmbajtjen e ndërtesave të banimit;
- rregullon, siguron dhe krijon kushte për zhvillimin e kulturës dhe mbrojtjes të mirave kulturore;
- rregullon, organizon dhe krijon kushte dhe kujdeset për zhvillimin e turizmit, si dhe zhvillimin e veprimtarive me të cilat përparohet zhvillimi i turizmit;
- krijon kushte për shfrytëzimin e tokës bujqësore dhe kujdeset për mbrojtjen e saj;
- në harmoni me mundësitë, merr pjesë dhe siguron kushte për avancimin (përparimin) e veprimtarisë së mbrojtjes shëndetësore, arsimit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, punësimit dhe fushave të tjera me interes për komunitetin lokal dhe ushtron të drejtat dhe obligimet e themeluesit të institucioneve që themelon për këto veprimtari, në pajtim me ligjin;
- në harmoni me mundësitë, rregullon dhe zgjidh nevojat për banim të personat në gjendje të nevojave sociale dhe personave me aftësi të kufizuara dhe ndihmon punën e organizatave humanitare dhe joqeveritare nga këto fusha;
- rregullon dhe siguron kushtet për informim të komunitetit lokal;
- krijon kushte për zhvillimin dhe përparimin e sportit, fëmijëve, të rinjve dhe qytetarëve, si dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërkomunal sportiv;
- rregullon dhe siguron kushtet për zhvillimin e veprimtarisë bibliotekare dhe veprimtarive të tjera me interes për popullatën lokale;
- zgjidh të drejtat në fushën e mbrojtjes së veteranëve dhe invalidëve dhe mban evidencë për shfrytëzuesit e të drejtave;
- rregullon dhe siguron kushtet për mbrojtjen dhe shpëtimin e popullatës, të mirave materiale dhe kulturore dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e komunës nga fatkeqësitë natyrore, fatkeqësitë teknike – teknologjike dhe fatkeqësitë e tjera;

- organizon dhe zbaton masat e mbrojtjes së popullatës nga sëmundjet infektive;
- krijon kushte për zhvillimin e prodhimitarisë bujqësore (pemëtari, kopshtari, ullishtari etj.) dhe kryen edhe punë të tjera nga kjo fushë;
- siguron kushte për mbrojtjen e konsumatorëve;
- rregullon mënyrën dhe kushtet e mbajtjes së kanakarëve (kafshëve shtëpiake) mënyrën e trajtimit të kafshëve të braktisura dhe të humbura, siguron kushtet për ushqyerjen e tyre dhe zbaton masat e kontrollit, riprodhimin e tyre;
- konfirmon orarin e punës në veprimtari të caktuara dhe përcakton zonat në të cilat mund të ushtrohet një veprimtari e caktuar;
- rregullon dhe siguron kushtet për mbajtjen e panairëve publike me rëndësi lokale;
- rregullon mënyrën e organizimit të punëve publike me rëndësi lokale dhe
- përcakton kundërvajtjet për shkeljen e dispozitave komunale.

Neni 32

Në kuadër të kompetencave të veta Komuna kryen edhe këto punë:

- 1) disponon, administron dhe mbron pronën e vet dhe ushtron disa autorizime pronësore në pronën shtetërore, në pajtim me ligjin;
- 2) rregullon, sjell dhe përcakton të hyrat e veta në pajtim me ligjin;
- 3) kryen punët e pagesës dhe kontrollit të hyrave të veta;
- 4) vendos për të drejtat, obligimet dhe interesat juridike të personave fizikë, personave juridikë dhe palëve të tjera në çështjet administrative dhe të tjera;
- 5) konfirmon interesin publik për shpronësimin e patundshmërive për realizimin e projekteve me interes lokal në pajtim me ligjin;
- 6) siguron zbatimin e aktiviteteve që kanë për qëllim përmirësimin e efikasitetit energjetik në objekte dhe sisteme të cilat shfrytëzojnë energjinë (ndërtesat, sistemet e trafikut publik, ndriçimi publik, furnizimi me ujë, administrimi i mbetjeve etj.), e të cilat për ushtrimin e veprimtarisë shfrytëzojnë organet e vetëqeverisjes lokale, organet e administratës lokale dhe shërbimet publike;
- 7) mbanë evidencën, në pajtim me ligjin;
- 8) kryen punët e mbikëqyrjes inspektuese dhe punët e sigurimit të rendit komunal, në pajtim me ligjin;
- 9) organizon dhe kryen punët e ofrimit të ndihmës juridike për qytetarët në pajtim me ligjin;
- 10) përcakton mirënjohjet dhe shpërblimet publike;
- 11) organizon shërbimin e ndihmës juridike për qytetarët;
- 12) siguron kushte për arritjen e barazisë gjinore dhe
- 13) kryen edhe punë të tjera në pajtim me nevojat dhe interesat e popullatës lokale.

Neni 33

Komuna mund të kryej edhe punë të tjera që janë me interes për popullatën vendore, të cilat nuk janë në kompetencë të organeve shtetërore ose organeve dhe organizatave të tjera.

Neni 34

Punët nga kompetencat e veta Komuna i kryen përmes organeve të veta, organeve të administratës lokale, institucioneve, shoqërive ekonomike dhe shërbimeve publike që është themelues i të cilave është, si dhe subjekteve të tjera, në pajtim me ligjin, Statutin dhe aktet e tjerë.

Neni 35

Përveç punëve nga kompetencat e veta, Komuna kryen edhe punë të cilat i janë deleguar me ligj ose i janë besuar me akt të Qeverisë.

Për kryerjen e punëve të deleguara dhe të besuara nga paragrafi 1 i këtij neni mjetet sigurohen nga buxheti i Malit të Zi në pajtim me aktin e delegimit, përkatësisht besimit të atyre punëve.

III – PASURIA DHE FINANCIMI

Neni 36

Komuna ka pasurinë dhe të hyrat.

Me pasurinë dhe të hyrat, Komuna disponon në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligjin.

Neni 37

Pasurinë e Komunës e përbëjnë sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, mjetet financiare, letrat me vlerë dhe të drejtat e tjera pronësore, në pajtim me ligjin.

Me pasurinë e Komunës disponon Kuvendi i Komunës, përveç në rastet e përcaktuara me ligj dhe këtë Statut.

Kuvendi i Komunës mund të kalojë të drejtën e dhënies së pronës me qira dhe të drejtën e shitjes së sendeve të luajtshme në organet e administratës lokale, në pajtim me një vendim të posaçëm.

Vendimin për blerjen e pronës në kuadër të mjeteve të planifikuara në Buxhetin e Komunës e sjell Kryetari i Komunës, në pajtim me ligjin.

Shitja ose ndërrimi i pronës së paluajtshme apo të luajtshme në pronësi të Komunës zbatohet sipas procedurës dhe mënyrës së rregulluar me ligj.

Organet nga paragrafët 2, 3 dhe 4 janë të detyruar të menaxhojnë, mbrojnë dhe disponojnë pronën, në pajtim me dedikimin e saj, me ndërgjegje, sipas parimeve të afarizmit të mirë, në pajtim me ligjin dhe këtë Statut.

Neni 38

Komuna dhe shërbimet publike themelues i të cilave është Komuna janë të obliguar që të mbajnë evidencë për pasurinë e vet, në pajtim me ligjin.

Vlerën e pasurisë së Komunës e vlerëson komisioni të cilin e formon Kuvendi i Komunës ose vlerësuesi i autorizuar me kërkesë të organit të Komunës kompetent për çështje të pasurisë në pajtim me ligjin.

Pasuria e Komunës pasqyrohet në pajtim me ligjin.

Kuvendi i Komunës e shqyrton raportin për gjendjen e pasurisë së Komunës dhe shërbimeve publike, së paku një herë në vit.

Neni 39

Për financimin e punëve nga kompetencat e veta Komunës i takojnë të ardhurat, në pajtim me ligjin.

Komuna siguron të ardhura për financimin e punëve të veta nga këto burime:

- të ardhurave vetanake (fiskale dhe të tjera),
- të ardhurave të transferuara me ligj,
- Fondi Egalizues,
- buxheti shtetëror dhe
- burimeve të tjera në pajtim me ligjin.

Neni 40

Komuna ka buxhetin e vet.

Komuna përgatit, planifikon dhe e administron buxhetin e Komunës në pajtim me ligjin.

Me buxhetin e Komunës pasqyrohen të gjitha të ardhurat që i takojnë Komunës dhe të gjitha shpenzimet nga kompetencat e saja.

Propozim vendimin e Buxhetit e konfirmon kryetari i Komunës dhe ia dorëzon Kuvendit të Komunës deri më 1 dhjetor të vitit aktual.

Buxheti i Komunës nxirret deri në fund të vitit aktual për vitin e ardhshëm. Nëse nuk nxirret deri në fund të vitit aktual, përkatësisht në fillim të vitit, nxirret Vendimi për financimin e përkohshëm për një periudhë më së gjati prej 3 muajsh.

Në rastet kur gjatë vitit fiskal vjen deri te zvogëlimi i të ardhurave të planifikuara ose rritjes së shpenzimeve të planifikuara, ndryshohet buxheti, sipas procedurës së paraparë për nxjerrjen e tij.

Neni 41

Mjetet financiare të buxhetit të Komunës depozitohen në llogarinë e konsoliduar të thesarit.

Llogarinë e konsoliduar të thesarit e hap organi i administratës lokale kompetent për punët e financave.

Nga llogaria e konsoliduar e thesarit nuk mund të bëhen pagesat të cilat nuk janë të lejuara me buxhet.

Organi i administratës lokale kompetent për çështje të financave është i autorizuar që t'i dërgojë kërkesë Ministrisë për hapjen e nënllogarisë, përkatësisht llogarive të tjera si pjesë integrale e llogarisë së konsoliduar të thesarit.

Mënyrën e shfrytëzimit të llogarisë nga paragrafi 4 i këtij neni e përcakton organi i administratës lokale kompetent për çështje të financave.

Organi i administratës lokale kompetent për çështje të financave menaxhon (administron) llogarinë e konsoliduar të thesarit.

Organi i administratës lokale kompetent për çështje të financave mban librin kryesor të thesarit.

Në librin kryesor të thesarit mbahet një evidencë e posaçme për secilën njësi shpenzuese të buxhetit të komunës.

Transaksionet dhe ngjarjet në librin kryesor të njërive shpenzuese të buxhetit të Komunës duhen të jenë në pajtim me transaksionet në librin kryesor të thesarit dhe me llogarinë e konsoliduar bankare lokale.

Neni 42

Mjetet e buxhetit përdoren për qëllimet për të cilat janë përcaktuar.

Për ekzekutimin e buxhetit të komunës, përgjegjës është kryetari i Komunës.

Për shfrytëzim të mjeteve të dedikuara buxhetore, përgjegjës është eprori i organit të administratës lokale kompetent për punët e buxhetit / ekzekutuesi i buxhetit.

Neni 43

Sekretari i Kuvendit të Komunës përgatit propozimin për sigurimin e mjeteve buxhetore për Kuvendin dhe Shërbimin e Kuvendit, si dhe është urdhërues i punëve financiare të Kuvendit dhe të Shërbimit të Kuvendit.

Neni 44

Mbikëqyrjen mbi ekzekutimin e buxhetit dhe përdorimin e dedikuar të mjeteve të cilat me buxhet dedikohen për qëllime të caktuara, e ushtron Kuvendi i Komunës.

Mbikëqyrja nga paragrafi 1 i këtij neni sigurohet me shqyrtimin periodik të raportit të ekzekutimit të buxhetit nga trupat kompetente parlamentare dhe Kuvendi i Komunës, si dhe shqyrtimin e Vendimit për buxhetin dhe Vendimit për llogarinë përfundimtare të buxhetit të Komunës.

Neni 45

Propozimin e llogarisë përfundimtare të buxhetit të Komunës për vitin paraprak e përcakton kryetari i Komunës dhe ia dorëzon Kuvendit të Komunës deri në fund të majit të vitit aktual.

Me llogarinë përfundimtare nga paragrafi 1 të këtij neni dorëzohen raportet financiare të shoqërive ekonomike, institucioneve dhe personave të tjerë juridikë, themelues i të cilave është Komuna për vitin për të cilin nxirret llogaria përfundimtare e buxhetit të Komunës.

Me llogarinë përfundimtare të buxhetit të Komunës, detyrimisht dorëzohet edhe Raporti i auditorit të jashtëm.

Neni 46

Mbikëqyrjen ndaj punëve financiare, materiale dhe të kontabilitetit të shfrytëzuesit të buxhetit në pikëpamjen e qëllimit, vëllimit dhe dinamikës së përdorimit të mjeteve, e ushtron kryetari i Komunës.

Mbikëqyrja nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet me dorëzimin e raportit gjysmëvjetor nga shfrytëzuesit e mjeteve buxhetore, raportit të shërbimit të revizionit të brendshëm, si dhe me shikim të drejtpërdrejtë tek shfrytëzuesi i mjeteve buxhetore nga ana e organit përgjegjës për punët e buxhetit.

Neni 47

Komuna mund të marrë hua në pajtim me ligjin.

Vendimin për marrjen e huas e sjell Kuvendi i Komunës.

IV - ORGANET E KOMUNËS

Neni 48

Organet e Komunës janë:

- Kuvendi i Komunës (në tekstin në vazhdim: Kuvendi) dhe
- Kryetari i Komunës.

Kuvendi

Neni 49

Kuvendi është organi përfaqësues i qytetarëve që kryen funksionin në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe këtë Statut.

Kuvendi përbëhet nga këshilltarët e zgjedhur nga qytetarët në bazë të së drejtës së votimit të lirë, të përgjithshëm, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, për një periudhë 4 vjeçare, në përputhje me ligjin që rregullon zgjedhjen e këshilltarëve dhe të deputetëve.

Numri i këshilltarëve në Kuvend përcaktohet me vendim të veçantë në pajtim me ligjin.

Neni 50

Mandati i këshilltarit fillon me verifikimin e mandatit nga ana e Kuvendit.

Verifikimi i mandatit të këshilltarit bëhet me dorëzimin e Raportit të Komisionit Zgjedhor Komunal për zgjedhjet e kryera.

Për verifikimin e mandateve Kuvendi nuk voton.

Neni 51

Seancën e parë të Kuvendit të sapozgjedhur e thërret kryetari i Kuvendit nga përbërja e mëparshme, jo më vonë se 15 ditë nga dita e shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Seanca e parë e Kuvendit të sapozgjedhur mbahet jo më vonë se 15 ditë nga dita e thirrjes së seancës.

Seancën e parë të Kuvendit të sapozgjedhur, deri në zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, e kryeson këshilltari më i vjetër.

Neni 52

Nëse seancën e Kuvendit nuk e thërret kryetari i Kuvendit brenda afatit të përcaktuar në nenin 51 paragrafi 1 i Statutit, seancën e thërret Qeveria në afat prej 15 ditësh nga dita e mbarimit të afatit të paraparë.

Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni, seanca mbahet jo më vonë se 15 ditë nga dita e thirrjes së seancës.

Neni 53

Kuvendi konsiderohet i konstituuar me zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit.

Nëse Kuvendi nuk konstituohet në afat prej 60 ditësh nga data e shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, Kryetari i Malit të Zi shpall zgjedhjet e reja për Kuvend.

Të drejtat dhe obligimet e këshilltarëve

Neni 54

Këshilltari ka të drejtë dhe obligim që: të marrë pjesë në punën e Kuvendit dhe trupave të tij punues; të kryejë detyrat e besuara; t'i propozojë Kuvendit shqyrtimin e çështjeve të caktuara brenda kompetencave të tij; të paraqesë propozime të vendimeve dhe akteve të tjera; të parashtrojë amendamente në propozimet e dispozitave; të parashtrojë pyetje të këshilltarëve; të kryejë edhe punë të tjera në përputhje me ligjin, Statutin dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Është e drejta e këshilltarit që gjithmonë dhe rregullisht të jetë i njoftuar për çështjet me rëndësi për ushtrimin e funksionit të këshilltarit, që nga organet dhe shërbimet profesionale, të kërkojë të dhëna të nevojshme për punën e tij, si dhe ndihmën profesionale në përgatitjen e propozimeve për Kuvend.

Këshilltari është i obliguar të ruaj informacionet e fshehta sekrete dhe të tjera të natyrës konfidenciale, për të cilën gjë është përgjegjës.

Neni 55

Këshilltari i Kuvendit ka të drejtë në kompensim për punën e tij në pajtim me vendimin e Kuvendit.

Neni 56

Këshilltari nuk mund të thirret në përgjegjësi për mendimin e shprehur, mënyrën e votimit ose fjalën e thënë gjatë ushtrimit të funksionit të këshilltarit.

Neni 57

Funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me funksionin e kryetarit të Komunës, nënkryetarit të komunës, administratorit kryesor, arkitektit kryesor të qytetit, menaxherit të Komunës, sekretarit të Kuvendit, eprorit të organit të administratës lokale, shërbimit profesional dhe atij të posaçëm dhe drejtuesit të shërbimit publik themelues i të cilit është komuna.

Punët e Kuvendit

Neni 58

Kuvendi:

- 1) sjellë statutin e komunës;
- 2) sjellë dispozita dhe akte të tjera të përgjithshme;
- 3) sjellë Planin strategjik zhvillimor të komunës;
- 4) sjellë plane dhe programe zhvillimore për fusha të caktuara;
- 5) sjellë projektet urbanistike;
- 6) sjellë Programin për rregullimin e hapësirës, përkatësisht Planin e paisjes komunale;
- 7) sjellë buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit;
- 8) sjellë dhe përcakton tatimet komunale, taksat, kompensimet dhe të ardhurat e tjera vetanake;
- 9) disponon me pasurinë e paluajtshme, përveç rasteve të tjetërsimit të të drejtave pronësore mbi pronën e paluajtshme me ujdi të drejtpërdrejtë, të përcaktuar me ligjin që rregullon pronën shtetërore;
- 10) përcakton kushtet për themelimin e bashkësive lokale dhe jep pëlqimin për vendimet mbi themelimin;
- 11) shpall referendumin për territorin e Komunës ose për një pjesë të territorit;
- 12) vendos për iniciativën qytetare;
- 13) vendos për shpalljen e vetëkontributit për territorin e Komunës;
- 14) themelon shërbimet publike;
- 15) vendos për huamarrje dhe dhënien e garancive, në përputhje me ligjin;
- 16) bënë konfirmimin e mandateve dhe vendos për të drejtat e këshilltarëve;
- 17) sjellë vendimin për shkurtimin e mandatit të Kuvendit;
- 18) zgjedh dhe shkarkon kryetarin e Kuvendit, kryetarin e Komunës dhe nënkryetarin e Kuvendit;
- 19) jep pëlqimin në vendimin për emërimin dhe shkarkimin e nënkryetarit të Komunës;
- 20) emëron sekretarin e Kuvendit, me propozim të kryetarit të Kuvendit;
- 21) emëron anëtarët e trupave punuese të Kuvendit;
- 22) emëron dhe shkarkon anëtarët e organeve drejtuese të shërbimeve publike;
- 23) shqyrton dhe aprovon Raportin e punës së kryetarit të Komunës dhe organeve të administratës lokale;
- 24) shqyrton Raportin e punës së shërbimeve publike themelues i të cilave është komuna;
- 25) shqyrton Raportin mbi zbatimin e rekomandimeve të Institucionit Shtetëror të Revizionit;
- 26) sjellë Rregulloren për punën e vet;
- 27) sjellë Kodin e Etikës;
- 28) sjellë Vendimin për pagat e funksionarëve lokalë dhe personave që i emëron Kuvendi;
- 29) sjellë Vendimin për pagat e zyrtarëve dhe nëpunësve lokalë;
- 30) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe Statut.

Kuvendi ka shërbimin profesional.

Trupat punuese

Neni 59

Me qëllim të kryerjes më efikase të punëve nga kompetencat e veta, Kuvendi formon këshillat dhe forumet, si trupa të përhershme punuese të Kuvendit.

Këshillat e Kuvendit janë:

1. Këshilli për Statut dhe Dispozita;
2. Këshilli për Zgjedhje dhe Emërime;
3. Këshilli për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
4. Këshilli për planifikimin hapësinor, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimtari komunale - banesore;
5. Këshilli për Veprimtari Shoqërore dhe
6. Këshilli për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe Ndërkombëtar.

Forumet parlamentare janë:

1. Forumi për dhënien e propozimeve të emërimit të lagjeve, rrugëve, shesheve dhe institucioneve;
2. Forumi për Mbrojtjen e Mjedisit;
3. Forumi për artin bashkëkohorë, trashëgiminë kulturore materiale dhe jomateriale ;
4. Forumi për bashkëpunim ndërmjet vetëqeverisjes lokale dhe OJQ-ve;
5. Forumi për Bashkëpunim me Diasporën;
6. Forumi për mirënjohjet publike të Komunës së Ulqinit
7. Forumi për ankesat dhe parashtrësat e qytetarëve;
8. Forumi për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar;
9. Forumi për Barazi Gjinore dhe të Drejtat e Pakicave dhe
10. Forumi për komunikacion lokal.

Kuvendi gjithashtu me vendim të posaçëm mund të formojë edhe trupa të tjerë punues.

Neni 60

Trupi punues ka kryetarin dhe një numër të caktuar të anëtarëve.

Përbërja e trupave punues të përhershëm korrespondon me përfaqësimin partiak të këshilltarëve në Kuvend. Për anëtarë të këshillave Kuvendi emëron këshilltarët e Kuvendit.

Për anëtarë të forumeve dhe komisioneve Kuvendi, përveç këshilltarëve, emëron edhe persona të tjerë, por që numri i tyre nuk mund të jetë më i madh se numri i këshilltarëve.

Anëtarët e trupave punuese të Kuvendit kanë të drejtë për kompensim në pajtim me vendimin e Kuvendit.

Neni 61

Përbërja, fushëveprimi, mënyra e punës dhe vendimmarrja e trupave punuese dhe çështjet të tjera të rëndësishme për punën e tyre, do të rregullohen me vendimin për trupat punuese të Kuvendit.

Me një vendim të veçantë, Kuvendi mund t'i besojë këshillave vendimmarrje për çështje të caktuara brenda kompetencave të veta, në përputhje me ligjin.

Neni 62

Kuvendi, sipas nevojës, mund të formojë komisione si trupa të përkohshme punuese të Kuvendit.

Aktet e Kuvendit

Neni 63

Në kryerjen e punëve nga kompetencat e veta, Kuvendi sjell statutin e komunës, vendime, aktvendime, përfundime, karta, rekomandime, plane, programe dhe akte të tjera:

Me vendime vendos për të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, themelon shërbimet publike dhe vendos për çështje të tjera në përputhje me ligjin dhe Statutin e Komunës.

Me aktvendime vendos për çështje të caktuara në përputhje me ligjin dhe dispozitat e tjera;

Kuvendi sjell përfundime për çështje të caktuara të rëndësishme për përcaktimin dhe zhvillimin e politikave në fusha të caktuara,

Me karta dhe rekomandime Kuvendi merr qëndrim në lidhje me çështje të caktuara sistematike nga kompetencat e veta, përkatësisht çështje që lidhen me organet e tjera dhe shërbimet publike;

Kuvendi mund të sjellë edhe akte të tjera nga kompetencat e veta.

Neni 64

Kuvendi sjell Programin e punës për vitin kalendarik.

Propozim Programi i Punës së Kuvendit përcaktohet nga kryetari i Kuvendit.

Procedura dhe mënyra e hartimit të Programit të Punës rregullohet me Rregulloren e Punës së Kuvendit

Neni 65

Të drejtën e propozimit të vendimeve, dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme e ka kryetari i Komunës, këshilltari dhe të paktën 2% e qytetarëve të regjistruar në listën e zgjedhësve, në territorin e Komunës.

Procedura për nxjerrjen e vendimeve, dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme fillohet me paraqitjen e propozimit të aktit nga propozuesi i autorizuar.

Neni 66

Kuvendi mund të vendosë nëse në seancë janë prezent shumica nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve.

Kuvendi sjell vendime me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

Për miratimin e Statutit dhe Rregullores së Punës, zgjedhjen dhe shkarkimin e kryetarit të Komunës, zgjedhjen dhe shkarkimin e kryetarit dhe nënkryetarit të Kuvendit, shkurtimin e mandatit të Kuvendit, buxhetin dhe llogarinë përfundimtare, raportin për punën e kryetarit të Komunës, detyrimet materiale të qytetarëve (tatimet, taksat etj.), vendimin për huamarrje të komunës, vetëkontributin, thirrjen e referendumit komunal, simbolet dhe ditën e Komunës si dhe vendimin për mirënjohjet dhe shpërblimet publike, Kuvendi vendosë me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve.

Neni 67

Vendimet dhe aktet e tjera të përgjithshme të Kuvendit hyjnë në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit të tyre në "Gazetën Zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës".

Përrjashtimisht, kur për atë ekzistojnë kushtet e përcaktuara në procedurën e nxjerrjes, mund të parashikohet që vendimi dhe akti tjetër i përgjithshëm të hyjë në fuqi jo më herët se në ditën e publikimit.

Neni 68

Procedura e nxjerrjes së vendimeve dhe akteve të tjera të Kuvendit, mënyra e punës dhe vendimmarrja e Kuvendit dhe trupave të tij punuese, instituti "Pyetje të këshilltarëve" dhe "Karriga e zbrazët" ("Karriga e lirë"), si dhe mënyra e publikimit të akteve të Kuvendit dhe çështjeve të tjera të rëndësishme për punën e Kuvendit, më për së afërmi rregullohen me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit

Neni 69

Kuvendi ka kryetarin.

Kryetarin e Kuvendit nga radhët e këshilltarëve e zgjedh Kuvendi, me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve.

Funksioni i kryetarit të Kuvendit është profesional.

Mandati i kryetarit të Kuvendit zgjatë aq sa edhe mandati i Kuvendit.

Neni 70

Kandidatin për kryetar të Kuvendit mund ta propozojë të paktën një e treta e këshilltarëve.

Këshilltari mund të marrë pjesë në propozimin e vetëm një kandidati.

Propozimi përmban: emrin dhe mbiemrin e kandidatit, biografinë e shkurtër, përkatësinë partiake, arsyetimin e propozimit të kandidatit dhe emrin e mbiemrin e përfaqësuesit i cili në emër të propozuesit do ta arsyetojë propozimin në Kuvend.

Neni 71

Propozimi i kandidatit për kryetar të Kuvendit i dorëzohet kryesuesit me shkrim dhe duhet të nënshkruhet personalisht nga parashtuesi i propozimit.

Me propozimin e propozuesit, dorëzohet pëlqimi me shkrim i kandidatit për pranimin e kandidaturës.

Kryesuesi ua dorëzon këshilltarëve propozimet e marra të kandidatëve për kryetar të Kuvendit.

Nëse ka më shumë se një propozim, kryesuesi do të përcaktojë listën e kandidatëve sipas rendit alfabetik të mbiemrave të kandidatëve.

Neni 72

Për propozimin e kandidatit hapet debati.

Përfaqësuesi i propozuesit ka të drejtë të shpjegojë me gojë propozimin, që mund të zgjasë deri në dhjetë minuta.

Neni 73

Kryetari i Kuvendit zgjidhet me votim të hapur.

Kuvendi mundet, me propozim të këshilltarit të cilin e mbështesin së paku një e treta e këshilltarëve, të vendosë që kryetari i Kuvendit të zgjidhet me votim të fshehtë.

Nëse për kryetar të Kuvendit janë propozuar më shumë se një kandidatë, zgjedhja bëhet me votim të fshehtë.

Neni 74

Votimi i hapur për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit bëhet me thirrjen e këshilltarëve dhe shqiptimin e qartë të fjalës "Pro", "Kundër" ose "Përmbajtur".

Neni 75

Për realizimin e votimit të fshehtë, Kuvendi, me propozimin e kryesuesit, formon komisionin prej tre anëtarësh nga radhët e këshilltarëve (në tekstin e mëtejme: Komisioni).

Përbërja e Komisionit i përgjigjet përfaqësimit partiak të Kuvendit.

Anëtari i Komisionit nuk mund të jetë këshilltar i cili është kandidat për kryetar të Kuvendit.

Neni 76

Votimi i fshehtë bëhet me fletëvotime të shtypura në numrin e këshilltarëve në Kuvend.

Fletëvotimet janë të njëjtës madhësi, ngjyrë dhe formë dhe janë të vërtetuara me vulën e Kuvendit.

Për çdo përsëritje të votimit në fletëvotim, shënohet shenja e këtij votimi, ose fletëvotimet shtypen me ngjyrë të ndryshme.

Për shtypjen dhe vulosjen e fletëvotimeve përgjegjës është sekretari i Kuvendit.

Neni 77

Fletëvotimi përmban mbiemrin dhe emrin e kandidatit sipas rendit alfabetik, dhe përpara mbiemrit të çdo kandidati, vendoset numri rendor.

Votimi bëhet duke rrumbullakuar numrin rendor para kandidatit për të cilin voton këshilltari.

Nëse në fletëvotim gjendet vetëm një kandidat për të cilin vendoset fletëvotimi përmban emrin dhe mbiemrin e kandidatit për të cilin votohet, nën emrin e kandidatit, fjala "Pro" në të majtë dhe fjala "Kundër" në anën e djathtë.

Këshilltari voton duke rrumbullakuar fjalën "Pro" ose fjalën "Kundër".

Neni 78

Votimin e fshehtë e udhëheq Komisioni, të cilit i ndihmon sekretari i Kuvendit.

Para fillimit të votimit, kryesuesi i mbledhjes jep shpjegimet e nevojshme për mënyrën e votimit dhe përcakton kohën e pushimit të kërkuar për të përcaktuar rezultatet e votimit.

Neni 79

Sekretari i Kuvendit bënë thirrjen, i dorëzon këshilltarit fletëvotimin dhe evidenton këshilltarët që kanë marrë fletëvotimin.

Pas votimit, këshilltari vendos fletëvotimin të palosur në kutinë e votimit.

Neni 80

Pas përfundimit të votimit, Komisioni do të vazhdojë të përcaktojë rezultatet e votimit në ambientet (hapësirat) në të cilat është bërë votimi.

Para hapjes së kutisë së votimit, përcaktohet numri i fletëvotimeve të papërdorura.

Komisioni harton një raport mbi rezultatet e votimit të fshehtë që përmban këto të dhëna: numrin e fletëvotimeve të dorëzuara, numrin e fletëvotimeve në kutinë e votimit, numrin e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme, numrin i votave "Pro" dhe "Kundër", përkatësisht numrin e votave për secilin kandidat, si dhe konstaton se cili kandidat është zgjedhur.

Neni 81

Fletëvotim i pavlefshëm konsiderohet: një fletëvotim i paplotësuar, fletëvotim i plotësuar në mënyrë që të mos mund të vërtetohet me siguri se si këshilltari ka votuar, si dhe fletëvotimi ku janë rrumbullakuar disa kandidatë.

Neni 82

Nëse për kryetar të Kuvendit është propozuar një kandidat dhe nuk ka marrë shumicën e nevojshme të votave, procedura e zgjedhjes përsëritet me kandidatin / kandidatët e rinj.

Nëse janë propozuar dy kandidatë dhe asnjëri nuk ka marrë shumicën e nevojshme të votave, procedura përsëritet me kandidatë të rinj.

Nëse janë propozuar më shumë se dy kandidatë dhe askush nuk ka marrë shumicën e votave, procedura e votimit përsëritet ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madhë të votave përkatësisht midis disa kandidatëve që kanë marrë numrin e njëjtë të votave.

Nëse, edhe në votimin e përsëritur, asnjëri nga kandidatët nuk ka marrë shumicën e kërkuar të votave, procedura e zgjedhjes përsëritet me kandidatë të rinj.

Neni 83

Në bazë të raportit të Komisionit për rezultatet e votimit, kryesuesi shpall rezultatet e votimit dhe emrin e kandidatit i cili është zgjedhur për kryetar të Kuvendit.

Rezultati i votimit shënohet në procesverbal.

Neni 84

Kryetari i Kuvendit jep betimin solemn para Kuvendit, pas së cilës ai hyn në detyrë.

Teksti i betimit solemn thotë: "Solemnisht obligohem që detyrat e kryetarit të Kuvendit do t'i ushtroj në përputhje me Kushtetutën, ligjin dhe Statutin e Komunës".

Neni 85

Kryetari i Kuvendit përfaqëson Kuvendin, thërret seancën e Kuvendit, kryeson dhe udhëheqë me punën e tij, përkujdeset për realizimin e vendimeve dhe akteve të tjera dhe kryen detyra të tjera në përputhje me Statutin, Rregulloren e Kuvendit, vendimet dhe aktet e tjera të Kuvendit.

Në rast të mungesës apo pengesës së kryetarit për të marrë pjesë, Kuvendi kryesohet nga nënkryetari i Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit e thërret seancën e Kuvendit sipas nevojës, por së paku një herë në tre muaj.

Kryetari i Kuvendit e thërret seancën e Kuvendit me nismën e vet, me kërkesë të kryetarit të Komunës, me kërkesë të së paku një të tretës së këshilltarëve dhe me iniciativë të qytetarëve.

Kryetari e thërret Kuvendin në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht iniciativës.

Neni 86

Iniciativën për thirrjen e seancës së Kuvendit mund ta dorëzojnë me shkrim së paku 2% e qytetarëve të regjistruar në listën e zgjedhësve nga territori i komunës.

Iniciativa për thirrjen e seancës duhet të nënshkruhet me emrin dhe mbiemrin e plotë, me numrin e letërnjoftimit ose numrin e pasaportës dhe adresën e vendbanimit.

Parashtruesi i kërkesës është i detyruar që në iniciativë të cekë arsyet për thirrjen e mbledhjes dhe të propozojë vendimin, dispozitën ose një akt tjetër për të rregulluar çështjet që do të jenë objekt i shqyrtimit.

Shkarkimi i kryetarit të Kuvendit

Neni 87

Kryetari i Kuvendit mund të shkarkohet përpara mbarimit të kohës për të cilën është zgjedhur nëse:

- nuk kryen detyrat e përcaktuara me ligjin, Statutin dhe me Rregulloren e Punës së Kuvendit;
- keqpërdor funksionin;
- me sjelljen e tij dëmton reputacionin e funksionit që kryen;
- shfaq një prej rasteve të papajtueshmërisë së ushtrimit të funksionit në pajtim me ligjin;
- në raste të tjera kur Kuvendi konstaton se është i paaftë për kryerjen e funksionit të tij.

Neni 88

Propozimi për shkarkimin e kryetarit të Kuvendit mund ta dorëzojnë më së paku një e treta e këshilltarëve të Kuvendit.

Propozimi i dorëzohet Kuvendit në formë të shkruar.

Propozimi duhet të përmbajë arsyet për të cilat propozohet shkarkimi.

Trupi kompetent i Kuvendit e vlerëson arsyeshmërinë e shkaqeve të përmbajtura në propozimin dhe për këtë i dorëzon raportin Kuvendit në afat prej 20 ditësh nga data e dorëzimit të propozimit.

Neni 89

Seancën e Kuvendit në të cilën vendoset për propozimin për shkarkimin e kryetarit të Kuvendit, kryetari i Kuvendit është i obliguar që ta thërrasë më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të propozimit për shkarkim.

Me thirrjen këshilltarëve u dorëzohet edhe propozimi për shkarkim.

Kuvendi sjell vendim për propozimin për shkarkim më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të propozimit.

Neni 90

Në rast se kryetari i Kuvendit nuk e thërret Kuvendin në afatin e paraparë në nenin 89 paragrafi 1 të këtij Statuti, Kuvendin do ta thërrasë parashtruesi i kërkesës për shkarkim.

Neni 91

Për propozimin për shkarkim hapet debati.

Para hapjes së debatit përfaqësuesi i propozuesit ka të drejtë të arsyetojë propozimin.

Kryetari i Kuvendit ka të drejtë të deklarohet për propozimin dhe arsyet e përmendura për shkarkimin e tij.

Kuvendi, pas shqyrtimit të propozimit për shkarkim, raportit të trupit punues të Kuvendit dhe debatit, sjell vendimin.

Neni 92

Kryetari i Kuvendit shkarkohet me votim të hapur.

Votimi i hapur bëhet me thirrjen e këshilltarëve dhe me shqiptimin e qartë të fjalëve "Pro", "Kundër" dhe "Përmbajtur".

Kuvendi, me propozimin e të paktën një të tretës së këshilltarëve, mund të vendosë që për propozimin për shkarkimin e kryetarit të Kuvendit të mbahet votim i fshehtë.

Votimi i fshehtë do të bëhet në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, të cilat kanë të bëjnë me vendosjen me votim të fshehtë.

Neni 93

Me seancën e Kuvendit, në të cilën diskutohet për propozimin për shkarkimin e kryetarit të Kuvendit, kryeson nënkryetari i Kuvendit.

Nëse Kuvendi nuk e pranon propozimin për shkarkimin e kryetarit të Kuvendit, i njëjti nuk mund të përsëritet në afat prej gjashtë muajve nga dita e votimit mbi shkarkimin.

Pushimi i mandatit të kryetarit të Kuvendit

Neni 94

Kryetarit të Kuvendit i pushon mandati sipas forcës së ligjit në rastet e përcaktuara me ligj.

Neni 95

Kryetarit të Kuvendit mandati i pushon me dhënien e dorëheqjes.

Dorëheqja dorëzohet në formë të shkruar.

Dorëheqjen e konstaton Kuvendi në mbledhjen e parë të radhës.

Në ditën e konstatimit të dorëheqjes, kryetarit të Kuvendit i pushon funksioni.

Nënkryetari i Kuvendit

Neni 96

Kuvendi ka nënkryetarin.

Nënkryetarin e Kuvendit nga radhët e këshilltarëve e zgjedh dhe e shkarkon Kuvendi, me propozimin e kryetarit të Kuvendit.

Mandati i nënkryetarit të Kuvendit zgjat sa edhe mandati i kryetarit të Kuvendit.

Nënkryetari i Kuvendit zëvendëson kryetarin e Kuvendit në rast të pamundësisë për të kryer detyrën e tij.

Nënkryetari i Kuvendit funksionin e kryen vullnetarisht.

Nënkryetari i Kuvendit zgjidhet dhe shkarkohet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve, në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me Rregulloren e Punës.

Neni 97

Kur kryetarit të Kuvendit, në rastet e parashikuara me ligj, i pushon mandati, funksionin e kryetarit të Kuvendit deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të Kuvendit e ushtron nënkryetari i Kuvendit.

Në rast të pushimit të mandatit të kryetarit të Kuvendit, Kuvendi është i detyruar të bëjë zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e pushimit të mandatit.

Neni 98

Nënkryetarit të Kuvendit mandati i pushon:

- me kalimin e kohës për të cilën është emëruar;

- me humbjen e shtetësisë malazeze;
- me ndryshimin e vendbanimit;
- kur me vendim të plotëfuqishëm i është hequr zotësia e veprimt;
- kur me aktgjykim të formës së prerë është dënuar për vepër e cila e bënë të padenjë për ushtrimin e funksionit;
- kur me aktgjykim të formës së prerë është dënuar me burgim të pakushtëzuar;
- me dhënien e dorëheqjes;
- me shkarkim;
- në raste të tjera të parashikuara me ligj.

Neni 99

Nënkryetari i Kuvendit shkarkohet nëse:

- nuk kryen detyrën në pajtim me ligjin, statutin dhe aktet e tjera;
- me sjelljen e vet dëmton reputacionin e funksionit që kryen;
- shfaqet një prej rasteve të papajtueshmërisë së ushtrimit të funksionit sipas ligjit;
- keqpërdor funksionin e tij;
- emërohet në ndonjë funksion tjetër publik;
- në raste të tjera kur Kuvendi vlerëson se është i paaftë për të kryer funksionin.

Sekretari i Kuvendit

Neni 100

Kuvendi ka sekretarin.

Sekretari i Kuvendit emërohet në bazë të konkursit publik, për një periudhë prej pesë vjetësh.

Sekretari emërohet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim të kryetarit të Kuvendit.

Vendimin për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e sekretarit të Kuvendit e sjell Këshilli i Kuvendit përgjegjës për zgjedhje dhe emërim.

Komisionin për verifikimin e aftësive profesionale për zgjedhjen e sekretarit të Kuvendit e formon Këshilli i Kuvendit nga paragrafi 4 i këtij neni.

Neni 101

Sekretari i Kuvendit organizon dhe kujdeset për kryerjen e punëve profesionale, administrative dhe të tjera për Kuvendin dhe trupat e tij punues dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me Statut dhe aktet e tjera të Kuvendit.

Sekretari i Kuvendit përgatit mbledhjet e Kuvendit dhe trupave të tij punuese;

- kujdeset për zbatimin e dispozitave të Statutit, të Rregullores së Punës dhe trupave të tij punuese;
- organizon dhe udhëheqë me shërbimin e Kuvendit,
- është përgjegjës për hartimin e procesverbalit, stenogramit ose regjistrimeve të tjera elektronike të mbledhjeve të Kuvendit, përpunimin e akteve të Kuvendit dhe për publikimin e vendimeve dhe akteve të tjera të përgjithshme të Kuvendit.

Sekretari i Kuvendit ndihmon kryetarin e Kuvendit në punën e tij, kryen dhe punë të tjera në përputhje me Statutin dhe aktet e tjera të Kuvendit.

Neni 102

Sekretari i përgjigjet kryetarit të Kuvendit dhe Kuvendit.

Akti për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës së Shërbimit të Kuvendit nxirret nga sekretari i Kuvendit me pëlqimin e kryetarit të Kuvendit.

Për të drejtat dhe detyrimet e sekretarit të Kuvendit vendos trupi punues kompetent i Kuvendit.

Neni 103

Sekretarit të Kuvendit i pushon mandati:

- me kalimin e kohës në të cilën është emëruar;
- me kërkesë personale;
- me pushimin e marrëdhënies së punës me fuqi të ligjit;
- me shkarkim.

Neni 104

Kuvendi e shkarkon sekretarin e Kuvendit për shkaqe të përcaktuara me ligj. Propozimi për shkarkimin e sekretarit të Kuvendit mund të parashtrohet nga kryetari i Kuvendit ose të paktën një e treta e këshilltarëve.

Neni 105

Propozimi për shkarkimin e sekretarit të Kuvendit i dorëzohet Kuvendit me shkrim dhe duhet të nënshkruhet personalisht nga ana e parashtruesit.

Propozimi duhet të përmbajë arsyet për të cilat kërkohet shkarkimi i sekretarit të Kuvendit, me arsyetim.

Për propozimin e shkarkimit të sekretarit të Kuvendit sigurohet mendimi i trupit kompetent punues të Kuvendit.

Para shqyrtimit në Kuvend, propozimi i dorëzohet sekretarit të Kuvendit, me qëllim që të njihet dhe të shprehet në lidhje me arsyet për të cilat kërkohet shkarkimi.

Në mbledhjen e Kuvendit, propozuesi ka të drejtë të shpjegojë propozimin dhe arsyet për të cilat kërkohet shkarkimi.

Sekretari i Kuvendit, me rastin e propozimit të parashtruar, ka të drejtë të deklarohet në mbledhjen e Kuvendit mbi arsyet për shkarkimin.

Pas mbylljes së debatit, kryetari i Kuvendit e qet në votim propozimin për shkarkimin e sekretarit të Kuvendit.

Sekretari i Kuvendit pas pushimit të funksionit i realizon të drejtat në përputhje me ligjin.

Kryetari i Komunës

Neni 106

Kryetari i Komunës është organi ekzekutiv i Komunës.

Funksioni i kryetarit të Komunës është profesional.

Kryetari i Komunës zgjedhet për një periudhë katër vjeçare.

Për kryetar të Komunës mund të zgjedhet personi i cili i plotëson kushtet për zgjedhjen e këshilltarëve në përputhje me ligjin që rregullon zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve.

Kryetarin e Komunës e zgjidh Kuvendi me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve.

Kryetarit të Komunës i cili është zgjedhur nga radhët e këshilltarëve, me zgjedhjen në funksionin e kryetarit të Komunës i pushon mandati i këshilltarit.

Neni 107

Kandidatin për kryetar të Komunës ka të drejtë ta propozojë të paktën një e treta e këshilltarëve në Kuvendin Komunal.

Kryetari i Komunës zgjedhet jo më vonë se 30 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit.

Këshilltari mund të mbështesë vetëm një kandidat.

Propozimi përmban: emrin dhe mbiemrin e kandidatit, biografinë e shkurtër, arsyetimin dhe emrin dhe mbiemrin e raportuesit në emër të propozuesit.

Propozimi për kandidatin për kryetar të Komunës i dorëzohet kryesuesit të Kuvendit me shkrim dhe duhet të nënshkruhet personalisht nga ana e parashtruesit.

Bashkë me propozimin dorëzohet pëlqimi i kandidatit për pranimin e kandidaturës.

Kryesuesi u dorëzon këshilltarëve propozimet për kryetarin e Komunës.

Për propozimin e kandidatit hapet debati.

Raportuesi në emër të propozuesit ka të drejtë të shpjegojë me gojë propozimin.

Neni 108

Procedura për zgjedhjen e kryetarit të Komunës kryhet në përputhje me dispozitat e këtij Statuti që rregullojnë procedurën për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit.

Neni 109

Kryetari i Komunës bën betimin solemn para Kuvendit.

Teksti i betimit solemnë është si vijon: " Solemnisht obligohem që detyrën e kryetarit të Komunës do ta kryej në pajtim me Kushtetutën, ligjin dhe Statutin e Komunës".

Punët e kryetarit të Komunës

Neni 110

Kryetari i Komunës:

- 1) prezanton dhe përfaqëson Komunën;
- 2) propozon dispozitat dhe aktet të tjera të cilat i sjell Kuvendi;
- 3) kujdeset dhe është përgjegjës për zbatimin e ligjeve, dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme, planit zhvillimor strategjik të komunës dhe planeve dhe programeve të tjera zhvillimore, si dhe për zbatimin e dokumenteve strategjike me rëndësi shtetërore;
- 4) kujdeset dhe është përgjegjës për zbatimin e punëve të deleguara dhe të besuara;
- 5) paraqet raportin mbi gjendjen e pasurisë së Komunës;
- 6) vendos për tjetërsimin e të drejtave pronësore të pronës së paluajtshme me marrëveshje të drejtpërdrejta, në përputhje me ligjin i cili rregullon pronën shtetërore;
- 7) përcakton organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale, me marrjen e mendimit paraprak të kryeadministratorit;
- 8) emëron dhe shkarkon nënkryetarin e Komunës, me pëlqimin e Kuvendit;
- 9) emëron dhe shkarkon kryeadministratorin, eprorët e organeve të administratës lokale dhe shërbimeve të posaçme;
- 10) emëron dhe shkarkon arkitektin kryesor të qytetit;
- 11) emëron dhe shkarkon menaxherin;
- 12) i paraqet Kuvendit raportin vjetor për punën e vetë dhe punën e organeve të administratës lokale dhe të shërbimeve publike, deri më 31 mars të vitit aktual për vitin e kaluar;
- 13) drejton dhe përshtatë punën e organeve të administratës lokale dhe të shërbimeve publike, me qëllim që në mënyrë më efektive të realizojë funksionet e tyre dhe të ofrojnë shërbime publike cilësore, për të cilën gjë nxjerrë akte përkatëse;
- 14) jep pëlqimin në aktin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e organeve të administratës lokale dhe shërbimeve publike;

15) ushtron mbikëqyrjen administrative mbi punën e organeve të administratës dhe shërbimeve publike;

16) sjell akte nga kompetencat e veta në zbatimin e punëve të deleguara dhe të besuara, në qoftë se kjo nuk është përcaktuar ndryshe me dispozita të veçanta;

17) është përgjegjës për zbatimin e vendimeve dhe akteve të tjera që i nxjerr Kuvendi dhe sjell akte për zbatimin e tyre;

18) sjell akte që sigurojnë zbatimin e buxhetit të Komunës;

19) sjell planin kadrovik;

20) sjell planin e integritetit;

21) sjell planin vjetor për trajnimin e zyrtarëve dhe nëpunësve lokalë;

22) kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara me ligj, këtë Statut dhe aktet e Komunës.

Kryetari i Komunës ka shërbimin profesional me të cilin udhëheqë.

Aktet e kryetarit të Komunës

Neni 111

Në kryerjen e detyrave të përcaktuara (parapara) me ligj dhe me këtë Statut, kryetari i Komunës nxjerr: vendime, udhëzime, rregullore, urdhëresa, aktvendime dhe përfundime.

Me vendim përcaktohet organizimi dhe mënyra e punës së administratës lokale, vendos për emërimin dhe shkarkimin dhe vendos për çështje të tjera në përputhje me autorizimet e përcaktuara me ligj apo dispozita të tjera.

Me udhëzim përshkruhet mënyra e punës dhe zbatimi i punëve të organeve të qeverisjes lokale dhe subjekteve të tjera që kryejnë punë me interes për Komunën në zbatimin e ligjeve, vendimeve të Kuvendit të Komunës dhe dispozitave të tjera.

Me rregullore më për së afërmi përpunohen disa çështje, të cilat janë rregulluar me ligj, vendimin e Kuvendit të Komunës dhe me dispozita të tjera.

Urdhëresa nxirret për të zgjidhur situata të caktuara konkrete që kanë rëndësi të përgjithshme në raste kur kjo është e parashikuar me ligj ose dispozita të tjera.

Me aktvendim vendoset për të drejtat dhe detyrimet individuale, për formimin e këshillave dhe komisioneve profesionale, zgjidh konfliktin e kompetencave, jep pëlqimin në akte që nxirren nga organet e administratës lokale dhe shërbimet publike dhe subjektet e tjera që kryejnë punë të interesit publik dhe raste të tjera, në përputhje me ligjin.

Me përfundim konfirmohen draftet e akteve të përgjithshme që qiten në shqyrtim publik, përcaktohen detyrat e organeve të administratës lokale dhe subjekteve që kryejnë punë me interes publik, merren qëndrime, vendoset për lejimin e mjeteve nga buxheti i komunës dhe për çështje të tjera nga kompetencat e kryetarit për të cilat nuk vendoset me akte të tjera .

Neni 112

Për kryerjen e punëve nga kompetencat e veta kryetari i Komunës i përgjigjet Kuvendit.

Për kryerjen e punëve të deleguara dhe të besuara, kryetari i Komunës i përgjigjet Qeverisë.

Neni 113

Kryetari i Komunës nxjerr përkohësisht akte nga kompetencat e Kuvendit në qoftë se Kuvendi nuk është në gjendje të mblidhet ose për arsye të tjera pamundësohet (pengohet) puna e tij, kurse me mos nxjerrjen e tyre do të pamundësohej realizimi i të drejtave dhe obligimeve të qytetarëve dhe do të rrezikohej pasuria me vlera të mëdha.

Kryetari është i detyruar që aktin nga paragrafi 1 i këtij neni t'ia paraqesë Kuvendit për miratim në seancën e parë pasuese.

Në qoftë se Kuvendi nuk e miraton aktin nga paragrafi 1 i këtij neni ose kryetari nuk e paraqet për miratim, ky akt pushon së qeni i vlefshëm në ditën e përfundimit të seancës.

Pushimi i mandatit

Neni 114

Kryetarit të Komunës i pushon mandati me kalimin e kohës për të cilin është zgjedhur, me shkarkim nga Kuvendi, me shkarkim nga Qeveria, me dorëheqje dhe me fuqinë ligjit.

Pushimi i mandatit të kryetarit të Komunës për shkak të dorëheqjes dhe fuqisë së ligjit, konstatohet me akt të Kuvendit.

Shkarkimi i kryetarit të Komunës

Neni 115

Kuvendi mund të shkarkojë kryetarin e Komunës nëse:

- në afatin e paraparë nuk e propozon buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit;

- nuk siguron zbatimin e planit strategjik të zhvillimit të Komunës, dhe planeve dhe programeve të tjera zhvillimore, si dhe dokumenteve strategjike me rëndësi shtetërore;

- nuk bënë dorëzimin e raportit vjetor për punën e tij dhe punën e organeve dhe shërbimeve në afatin e paraparë me ligj;

- nuk ekzekuton vendimet gjyqësore.

Propozimi për shkarkimin e kryetarit mund të parashtrohet nga të paktën një e treta e këshilltarëve.

Kryetari i Komunës ka të drejtë që në seancën e Kuvendit të deklarohet për propozimin e parashtruar.

Kuvendi për propozimin për shkarkimin e kryetarit të Komunës vendos me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve, në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të propozimit.

Neni 116

Në përmbajtjen e propozimit dhe procedurën sipas propozimit për shkarkimin e kryetarit të Komunës përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Statutit me të cilat rregullohet procedura për shkarkimin e kryetarit të Kuvendit.

Neni 117

Dispozitat e Ligjit mbi pushimin e mandatit të kryetarit të Komunës përpara mbarimit të kohës në të cilën është zgjedhur, me dhënien e dorëheqjes, me fuqinë e ligjit ose me shkarkim nga ana e Qeverisë, zbatohen drejtpërdrejt.

Neni 118

Në rastin e pushimit të mandatit të kryetarit të Komunës, funksionin e kryetarit, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të Komunës, e kryen nënkryetari i Komunës, të cilin e cakton Kuvendi.

Në rastin e pushimit të mandatit të kryetarit të Komunës, zgjedhja e kryetarit të Komunës kryhet jo më vonë se 30 ditë nga dita e pushimit të mandatit.

Nënkryetari i Komunës

Neni 119

Komuna ka më së shumti dy nënkryetarë.

Numrin e nënkryetarëve, me propozim të kryetarit të Komunës, e përcakton Kuvendi me vendim të posaçëm.

Neni 120

Nënkryetari i Komunës përcjellë punën e organeve të administratës lokale dhe shërbimeve publike në fushat për të cilat e angazhon kryetari i Komunës dhe kujdeset për zbatimin e politikave në ato fusha.

Nënkryetari i Komunës zëvendëson kryetarin e Komunës në rast të mungesës ose pamundësisë së tij për të kryer funksionin e në kuadër të autorizimeve që ia beson kryetari.

Mandati i nënkryetarit të Komunës zgjat po aq sa zgjat edhe mandati i kryetarit të Komunës.

Përrjashtimisht, në rast të pushimit të mandatit të kryetarit të Komunës, nënkryetarit të Komunës të cilin e cakton Kuvendi që të kryej funksionin e Kryetarit të Komunës, mandati i zgjat deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të Komunës, në pajtim me ligjin.

Neni 121

Nënkryetarit mandati i pushon para kohës për të cilën është emëruar me shkarkim, me dhënien e dorëheqjes dhe me fuqinë e ligjit.

Nënkryetari i Komunës mund të shkarkohet nëse nuk kryen ose kryen pa ndërgjegje detyrat e përcaktuara me ligj dhe me Statut.

Kryetari i Komunës ngrit procedurën për dhënien e pëlqimit për shkarkimin e nënkryetarit me shkrim me arsyetim, të cilin ia dorëzon Kuvendit.

Në procedurën e shkarkimit, nënkryetari në mbledhje ka të drejtë të deklarohet për arsyet që kërkohet shkarkimi i tij.

Nënkryetari i Komunës mund të japë dorëheqjen, për të cilën gjë e informon kryetarin e Komunës.

V - ADMINISTRATA LOKALE

Organet e administratës lokale

Neni 122

Për kryerjen e punëve të administratës lokale formohen organet e administratës lokale (sekretariatet, administratat dhe drejtoritë).

Për kryerjen e punëve profesionale nga kompetencat e kryeadministratorit dhe arkitektit kryesor të qytetit, si dhe detyrave të përbashkëta profesionale dhe të tjera për nevojat e Komunës mund të formohen shërbimet profesionale.

Për kryerjen e punëve specifike të administratës lokale formohen shërbimet e veçanta (shërbimi i policisë komunale, shërbimi i mbrojtjes dhe shpëtimit, etj.) në pajtim me ligjin.

Organizimi dhe mënyra e punës së administratës lokale përcaktohet me vendim të cilin e nxjerr kryetari i Komunës, me mendimin paraprak të kryeadministratorit, në pajtim me ligjin.

Neni 123

Në Komunën e Ulqinit punët e mbrojtjes së interesave pronësore juridike të Komunës i kryen Drejtoria për pronë dhe mbrojtjen e interesave pronësore juridike, e cila ka

pozitën e përfaqësuesit ligjor të Komunës në kryerjen e punëve të mbrojtjes së interesave pronësore juridike të komunës në gjykata dhe organet e tjera.

Neni 124

Organet e administratës vendore kryejnë punë në pajtim me ligjin, vendimet e Kuvendit dhe kryetarit të Komunës.

Organet e administratës vendore i dorëzojnë kryetarit të Komunës raportet e punës së tyre të paktën një herë në vit deri në fund të shkurtit të vitit aktual për vitin paraprak.

Kryeadministratori

Neni 125

Kryeadministratori kryen punë të përcaktuara me ligj, Statutin e Komunës dhe aktet e kryetarit të Komunës.

Kryeadministratori emërohet në bazë të konkursit publik, për një periudhë prej 5 vitesh, në përputhje me ligjin.

Për kryeadministrator mund të emërohet personi i cili e ka nivelin VII1 të kualifikimit arsimor, fakultetin e drejtësisë, që e ka të dhënë provimin e jurisprudencës dhe së paku pesë vjet përvojë pune.

Kryeadministratori ka shërbimin vet që e udhëheqë dhe është përgjegjës për punën e tij.

Pushimi i mandatit

Neni 126

Kryeadministratorit i pushon mandati:

- me kalimin e kohës për të cilën është emëruar;
- me kërkesë personale;
- me pushimin e marrëdhënies së punës sipas fuqisë së ligjit;
- me shkarkim.

Neni 127

Kryeadministratori shkarkohet në rastet e përcaktuara me ligj.

Procedurën për shkarkimin e kryeadministratorit e inicon kryetari i Komunës.

Akti për fillimin e procedurës për shkarkimin e kryeadministratorit përmban arsyet për të cilat fillohet procedura për shkarkimin e tij.

Akti për nisjen e procedurës për shkarkim i dorëzohet kryeadministratorit i cili ka të drejtë që, në afat prej 10 ditësh nga dita e marrjes së aktit për nisjen e procedurës, të deklarojë për shkaqet për shkarkim të pashtuara në aktin për nisjen e procedurës.

Neni 128

Pas mbarimit të afatit për shpjegim kryetari i Komunës nxjerr aktin për shkarkimin e kryeadministratorit.

Kryeadministratori, pas pushimit të funksionit, i realizon të drejtat në pajtim me ligjin.

Eprori i organit

Neni 129

Punën e organit të administratës lokale e udhëheqë eprori i organit, përkatësisht udhëheqësi i shërbimit (në tekstin e mëtejshëm: eprori i organit).

Eprori i organit, emërohet në bazë të konkursit publik për një periudhë prej 5 vitesh, në përputhje me ligjin.

Udhëheqësit të organit, i pushon mandati dhe shkarkohet për arsyet e përcaktuara me ligj.

Neni 130

Procedurën për shkarkimin e eprorit të organit e inicon kryetari i Komunës.

Akti për nisjen e procedurës për shkarkimin e eprorit udhëheqësit të organit përmban arsyet pse është filluar procedura për shkarkimin e tij.

Akti për nisjen e procedurës për shkarkim i dorëzohet eprorit të organit i cili ka të drejtë që në afat prej 10 ditësh, nga dita e marrjes së aktit për nisjen e procedurës, të shpjegojë arsyet për shkarkim të parashtruara në aktin për nisjen e procedurës.

Neni 131

Pas mbarimit të afatit për shpjegim kryetari i Komunës nxjerr aktin për shkarkimin e eprorit të organit.

Eprori i organit, pas pushimit të funksionit, i realizon të drejtat në pajtim me ligjin.

Neni 132

Eprori i organit mund të ketë ndihmësin.

Ndihmësi i eprorit të organit emërohet në bazë të konkursit publik, për një periudhë prej pesë vitesh.

Vendimin për vendosjen e ndihmësit të eprorit të organit, përkatësisht shërbimit e sjell eprori i organit, përkatësisht shërbimit, me pëlqimin e kryetarit të Komunës.

Ndihmësit të eprorit të organit i përfundon mandati dhe shkarkohet në pajtim me ligjin dhe këtë Statut.

Neni 133

Procedura për shkarkimin e ndihmësit të eprorit të organit inicohet nga eprori i organit me aktin për nisjen e procedurës për shkarkim, i cili përmban arsyet për shkarkim.

Akti për nisjen e procedurës i dorëzohet ndihmësit të eprorit të organit i cili ka të drejtë që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të aktit të deklarohet në raport me arsyet e dhëna në akt.

Neni 134

Pas mbarimit të afatit për deklarim eprori i organit, me pëlqim paraprak të kryetarit të Komunës, nxjerr aktin për shkarkimin e ndihmësit të vet, i cili përmban arsyet për të cilat shkarkohet ndihmësi.

Pas përfundimit të funksionit, ndihmësi i eprorit të organit i realizon të drejtat në pajtim me ligjin.

Neni 135

Komuna ka arkitektin e qytetit, i cili kryen detyrat e përcaktuara me ligjin që rregullon planifikimin e hapësirës dhe ndërtimin e objekteve.

Në qoftë se për kryerjen e punës së arkitektit kryesor të qytetit formohet shërbimi profesional me atë shërbim udhëheq arkitekti kryesor i qytetit dhe është përgjegjës për punën e tij.

Në rastin si nga paragrafi 2 i këtij neni, arkitekti kryesor i qytetit nxjerr aktin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e shërbimit profesional, vendos për përzgjedhjen e kandidatëve në procedurën e krijimit të marrëdhënies së punës dhe të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në shërbim.

Arkitekti kryesor i qytetit emërohet në bazë të konkursit publik, për një periudhë prej 5 vitesh.

Arkitekti kryesor i qytetit shkarkohet nëse:

- nuk i kryen ose i kryen me pa përgjegjësi detyrat e përcaktuara me ligj, Statutin e Komunës dhe aktet e kryetarit të Komunës;
- është dënuar me aktgjykim të formës së prerë me burgim të pakushtëzuar;
- është dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepër penale që e bën atë të padenjë për kryerjen e funksionit;
- kryetari i Komunës nuk e pranon Raportin vjetor për punën e tij.

Neni 136

Komuna ka menaxherin.

Menaxheri propozon dhe merr pjesë në përgatitjen dhe zbatimin e planeve dhe programeve zhvillimore të komunës me të cilat nxitet zhvillimi ekonomik, nismat sipërmarrëse dhe partneriteti publik-privat, sigurohet mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm, përgatit dhe menaxhon projekte të financuara nga fondet ndërkombëtare dhe burimeve të tjera, përcjell zbatimin e tyre, përgatit informata dhe raporte për zbatimin e projekteve, krijon dhe udhëheq bazën e të dhënave të planeve, programeve dhe projekteve, inicon ndryshime dhe plotësime të dispozitave të cilat vështirësojnë iniciativën e biznesit dhe kryen punë të tjera të cilat ia beson kryetari i Komunës.

Menaxheri vendoset, në bazë të konkursit publik, për një periudhë prej pesë vitesh.

Mandati i menaxherit pushon:

- me kalimin e kohës në të cilën është vendosur;
- me kërkesë personale;
- me pushimin e marrëdhënieve të punës me fuqinë e ligjit;
- me shkarkim.

Menaxheri shkarkohet nëse:

- nuk i kryen ose i kryen me pa përgjegjësi detyrat e përcaktuara me ligj, Statutin e Komunës dhe aktet e kryetarit të Komunës;
- është dënuar me aktgjykim të formës së prerë me burgim të pakushtëzuar;
- është dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepër penale që e bën atë të padenjë për kryerjen e funksionit;
- kryetari i Komunës nuk e pranon Raportin vjetor për punën e tij.

Neni 137

Në mënyrën dhe procedurën e shkarkimit të ndihmësit të eprorit të organit, arkitektit kryesor të qytetit dhe menaxherit, në përputhje zbatohen dispozitat e këtij Statuti me të cilat rregullohet mënyra dhe procedura e shkarkimit të eprorëve të organeve.

VI - MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Neni 138

Me qëllim të menaxhimit të burimeve njerëzore në Komunë, nxirret Plani kadrovik me të cilin planifikohet numri i punonjësve, ndryshimet në strukturën kadrovike dhe çështjet e tjera të menaxhimit të kuadrove në përputhje me planifikimin e buxhetit dhe planifikimin strategjik të punës së komunës.

Neni 139

Planin kadrovik për organet e administratës lokale, shërbimet profesionale përkatësisht shërbimet e posaçme e nxjerr kryetari i Komunës dhe është përgjegjës për zbatimin e tij.

Plani kadrovik nxirret për vitin kalendarik brenda 30 ditëve nga dita e miratimit të buxhetit të Komunës dhe përmban projeksione për dy vitet e ardhshme.

Në çështjet e përmbajtjes, procedurës dhe mënyrës së përgatitjes dhe ndryshimit të Planit kadrovik në pajtim zbatohen dispozitat për zyrtarët dhe nëpunësit shtetërorë.

Neni 140

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore kryen punë që kanë të bëjnë me:

- realizimin e shpalljeve për nevojat e organeve të administratës lokale, shërbimeve profesionale dhe shërbimeve të posaçme dhe njoftimin e organit kompetent të inspektimit mbi paligjshmërinë dhe parregullsitë eventuale;

- propozimin e Planit kadrovik për organet e administratës lokale, shërbimeve profesionale, përkatësisht shërbimeve të posaçme;

- udhëheqjen e evidencës kadrovike të zyrtarëve dhe nëpunësve lokalë dhe evidencat e brendshme të punës;

- hulumtimi i mundësisë për sistemimin e nëpunësve, përkatësisht zyrtarëve lokalë në vende të lira pune në organet e administratës lokale, shërbimin profesional, përkatësisht në shërbimin e posaçëm;

- monitorimin e zbatimit të masave me qëllim arritjen e përfaqësimit proporcional të pjesëtarëve të pakicave dhe komuniteteve të tjera kombëtare të pakicave në organe dhe shërbime, përfaqësimin e balancuar gjinor dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;

- çështje të tjera në fushën e zhvillimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore një herë në vit i paraqet kryetarit të Komunës Raportin e punës.

Neni 141

Evidenca kadrovike përfshinë të dhënat për organin dhe shërbimin, aktin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e organit dhe shërbimit, vendet e paplotësuara të punës, praktikantët, zyrtarët dhe nëpunësit lokalë, si dhe të dhënat mbi bazën e të cilave do të llogariten pagat e të punësuarve dhe të dhëna të tjera me rëndësi për menaxhimin e kuadrove.

Evidenca e tregut të brendshëm të punës përfshinë të dhënat për: nëpunësit lokalë, përkatësisht zyrtarët që janë në dispozicion, si dhe të dhënat e tjera të nevojshme.

Njësia për Burimeve Njerëzore është e detyruar të bëjë futjen e të dhënave në afat prej 15 ditëve nga paraqitja ose ndryshimi i rrethanave për të cilat mbahet evidenca.

Të dhënat nga evidenca kadrovike dhe evidenca e tregut të brendshëm të punës mund të jenë në dispozicion të një pale të tretë vetëm me pëlqimin e nëpunësit, përkatësisht zyrtarit të cilit i përkasin të dhënat.

Në aspektin e përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes të evidencës kadrovike, evidencat në tregun e brendshëm të punës, futja dhe përdorimi i të dhënave, në pajtim aplikohen dispozitat për zyrtarët dhe nëpunësit shtetërorë.

Neni 142

Të dhënat nga evidenca kadrovike, sipas detyrës zyrtare, i dorëzohen Administratës për kuadro e cila mbanë evidencën qendrore kadrovike.

Neni 143

Mbledhja, ruajtja dhe përpunimi i të dhënave për zyrtarët dhe nëpunësit lokalë bëhet në përputhje me ligjin që rregullon mbrojtjen e të dhënave personale.

VII - VETËQEVERISJA VENDORE

Bashkësitë lokale

Neni 144

Në territorin e Komunës, themelohen bashkësitë lokale si formë e vetëqeverisjes vendore përmes së cilës qytetarët marrin pjesë direkt në vendimmarrje për çështje me interes direkt dhe të përbashkët për popullatën lokale, në përputhje me ligjin, këtë Statut dhe vendimin e veçantë të Kuvendit.

Qytetarët themelojnë bashkësinë lokale, në përputhje me vendimin e Kuvendit.

Me vendim nga paragrafi 2 i këtij neni rregullohen kushtet e themelimit, punët, organet dhe procedurat e zgjedhjes, organizimi dhe puna e organeve, mënyra e vendimmarrjes, financimit dhe çështjeve të tjera me rëndësi për punën e bashkësisë lokale.

Neni 145

Në bashkësinë lokale, qytetarët marrin pjesë dhe vendosin për çështje me interes direkt dhe të përbashkët për qytetarët nga ajo zonë, e në veçanti:

- propozojnë dhe marrin pjesë në përgatitjen e programeve zhvillimore dhe nxjerrjen e planeve shumëvjeçare të investimeve të komunës, ndërtimin e infrastrukturës publike, realizimin e investimeve komunale dhe mbikëqyrjen e punimeve të realizuara;
- marrin pjesë në përgatitjen e programeve të furnizimit me ujë në zonat rurale;
- propozojnë rehabilitimin (rregullimin) e deponive komunale të mbetjeve dhe marrin pjesë në rehabilitimin (rregullimin) e tyre;
- propozojnë rregullimin dhe zbukurimin e hapësirës, rregullimin dhe zbukurimin e shëtitorës dhe marrin pjesë në të;
- Inicojnë rregullimin shtesë të trafikut (sinjalizimin, rrugët hyrëse, etj.);
- parashtrojnë nisma për ndryshimin e planeve hapësinore dhe urbane;
- informojnë organin kompetent të Komunës për problemet dhe nevojat e banorëve të bashkësisë lokale në fushën e planifikimit hapësinor dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- marrin pjesë në organizimin e shfaqjeve dhe manifestimeve kulturore, sportive dhe ngjarjeve të tjera;
- marrin pjesë në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve lokale dhe të pakategorizuara;
- marrin pjesë në menaxhimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e ujësjellësve ruralë, varrezave dhe objekteve të tjera komunale;
- parashtrojnë nisma për zgjidhjen e nevojave sociale të popullsisë;
- marrin pjesë në mbrojtjen dhe shpëtimin nga fatkeqësitë natyrore;
- parashtrojnë propozime dhe nisma edhe në fusha të tjera të jetës dhe të punës me interes për popullatën lokale.

Neni 146

Mënyra e pjesëmarrjes së popullatës vendore në vendimmarrje për çështje me interes të përbashkët dhe çështje të tjera që kanë lidhje me organizimin dhe punën e bashkësisë lokale, do të rregullohen me aktin për themelim dhe me Statutin e bashkësisë lokale në pajtim me ligjin dhe këtë Statut.

Neni 147

Mjetet për plotësimin e nevojave të popullatës lokale në bashkësinë lokale, sigurohen në pajtim me ligjin dhe vendimin për bashkësitë lokale.

VIII - PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË ARRITJEN E VETËQEVERISJES LOKALE

Neni 148

Komuna krijon kushte, inkurajon dhe ndihmon pjesëmarrjen e popullatës lokale (vendore) në arritjen e vetëqeverisjes vendore përmes formave të ndryshme të pjesëmarrjes së popullsisë në deklarimin dhe vendimmarrjen për çështjeve me interes të përbashkët.

Qytetarët marrin pjesë drejtpërsëdrejti në deklarim dhe vendimmarrje: me iniciativë, iniciativën qytetare, në tubimin e qytetarëve dhe referendumin (komunal dhe lokal).

Iniciativa

Neni 149

Qytetarët kanë të drejtë të parashtrojnë iniciativa organit kompetent të pushtetit lokal me qëllim të shqyrtimit dhe vendimmarrjes për çështje të caktuara me interes për popullatën lokale në pajtim me ligjin.

Për iniciativën e parashtruar organi kompetent i administratës lokale është i detyruar të marrë qëndrim në afat prej 30 ditësh dhe për këtë ta informojë parashtruesin e iniciativës.

Nëse organi kompetent nuk e njofton parashtruesin për qëndrimin e marrë në lidhje me iniciativën nga paragrafi 2 të këtij neni, ose parashtruesi është i pakënaqur me qëndrimin e organit, parashtruesi i iniciativës mund t'i drejtohet kryetarit të Komunës ose Kuvendit të Komunës.

Kryetari i Komunës ose Kuvendi i Komunës, pas marrjes së njoftimit nga paragrafi paraprak, janë të obliguar të informojnë parashtruesin për qëndrimin e vet, përkatësisht për masat e marra për këtë në afat prej 30 ditësh.

Iniciativa qytetare

Neni 150

Qytetarët mundin që organeve të Komunës t'u drejtojnë iniciativa qytetare për nxjerrjen ose ndryshimin e aktit me të cilin rregullohen çështje nga kompetenca e Komunës, e që janë me rëndësi për qytetarët.

Iniciativa qytetare mund të inicohet për çështje të tilla si: planifikimi dhe rregullimi i hapësirës, mbrojtja e mjedisit, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve komunale dhe infrastrukturës tjetër, ofrimi i shërbimeve nga veprimtaria komunale, tatimet, kompensimet dhe taksat, kultura dhe sporti, si dhe çështje të tjera nga kompetencat e Komunës.

Neni 151

Iniciativa qytetare mund të parashtrohet nga të paktën 2% e votuesve të regjistruar në listën e zgjedhësve të Komunës, sipas të dhënave për numrin e zgjedhësve nga zgjedhjet e fundit.

Iniciativa qytetare duhet të nënshkruhet personalisht nga parashtruesi me të dhënat: emri, mbiemri, numri i letërnjoftimit ose pasaportës dhe adresa e vendbanimit.

Iniciativa qytetare që është parashtruar në kundërshtim me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni do të konsiderohet e paplotë dhe do t'u kthehet parashtruesve për plotësim.

Neni 152

Organi i Komunës, të cilit i është drejtuar iniciativa qytetare ia dorëzon iniciativën organit kompetent të administratës lokale dhe trupit punues të Kuvendit përgjegjës për çështjet e iniciuara me iniciativën qytetare, me qëllim të shqyrtimit dhe dhënien e mendimit.

Organi, përkatësisht trupi punues nga paragrafi 1 i këtij neni, janë të obliguar që mendimin e vet ta japin në afatin prej 15 ditësh nga data e dorëzimit të iniciativës qytetare.

Neni 153

Organi i Komunës të cilit i është adresuar iniciativa qytetare është i detyruar të deklarohet për iniciativën qytetare në afat prej 15 ditësh nga data e marrjes së mendimit.

Kur organi i Komunës e pranon nismën qytetare, do të autorizojë organin kompetent të administratës lokale, që në afat prej 60 ditësh, të përgatisë propozim aktin për zgjidhjen e çështjes që është subjekt i nismës qytetare.

Në hartimin e aktit, organi nga paragrafi 2 i këtij neni , është i detyruar të mundësojë pjesëmarrjen e përfaqësuesit të parashtruesit të iniciativës qytetare, si dhe pjesëmarrjen në punën e Kuvendit gjatë shqyrtimit dhe vendosjes mbi propozimin e aktit.

Tubimi i qytetarëve

Neni 154

Tubimin e qytetarëve e thërret organi i bashkësisë lokale me iniciativën e tij ose me propozimin e së paku 1% të qytetarëve të rritur me vendbanim të përhershëm ose pronë në zonën për të cilën është organizuar tubimi ose me propozimin e eprorit të organit të administratës lokale, përkatësisht udhëheqësit të shërbimit publik.

Tubimin e qytetarëve mund ta thërrasë edhe kryetari i Komunës, kryetari i Kuvendit dhe këshilltari nga ajo zonë.

Tubimi i qytetarëve thirret me qëllim të marrjes së mendimit, përkatësisht qëndrimit të qytetarëve për çështje të caktuara të rëndësishme për jetën e qytetarëve në atë zonë.

Neni 155

Propozimi për thirrjen e tubimit të qytetarëve parashtrohet me shkrim dhe përmban çështjet që do të shqyrtohen në tubimin e qytetarëve.

Në qoftë se propozimin për thirrjen e tubimit e parashtrojnë qytetarët, propozimi duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin e qytetarit, adresën e banesës dhe nënshkrimin.

Neni 156

Në qoftë se janë plotësuar kushtet për thirrjen e tubimit, tubimi do të thirret më së shpejti në afat prej 8 dhe më së voni në afat prej 30 ditësh nga marrja e propozimit për thirrjen e tubimit.

Tubimi i qytetarëve thirret me dërgimin e thirrjes publike së paku 7 ditë para ditës së mbajtjes së tubimit.

Thirrja përmban propozimin e çështjeve që do të shqyrtohen në tubim, kohën dhe vendin e mbajtjes.

Ftesa publikohet në faqen e internetit dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës, në tabelën e njoftimeve të bashkësisë lokale, në media, në vende të tjera të shpalljeve dhe në mënyrë tjetër të përshtatshme.

Neni 157

Për vendimmarrje të plotfuqishme në tubimin e qytetarëve duhet të jenë të pranishëm të paktën 3% e qytetarëve të zonës për të cilën është thirr tubimi.

Tubimi i qytetarëve vendos me shumicën e votave të pjesëmarrësve të pranishëm.

Neni 158

Qytetarët në tubim:

- japin propozime për organet e komunës në lidhje me përgatitjen e programeve dhe planeve zhvillimore të komunës, planin e rregullimit hapësinor, mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit;

- shqyrtojnë iniciativa dhe propozime për formimin e bashkësisë lokale dhe ndryshimin në kufijve të bashkësisë lokale;

- japin propozime me rastin e çështjeve të tjera me rëndësi për popullatën lokale, në përputhje me ligjin, Statutin dhe vendimin e Kuvendit.

Referendumi

Neni 159

Me qëllim të deklarimit të qytetarëve për çështje të caktuara nga kompetencat e Komunës, mund të shpallet referendumi për territorin e komunës (referendumi komunal) ose për një pjesë të territorit të komunës (referendumi lokal).

Neni 160

Referendumi komunal mund të shpallet me qëllim të deklarimit paraprak të qytetarëve: për futjen e vetëkontributit për territorin e komunës, ndërtimin e objekteve të infrastrukturës në interes për komunën, vendosjen për çështje të iniciuara me iniciativën qytetare që nuk e ka pranuar Kuvendi, për çështjet me rëndësi për avancimin dhe mbrojtjen e mjedisit, si dhe për çështje të tjera të një rëndësie të veçantë nga kompetencat e Komunës për të cilat Kuvendi ka të drejtë të nxjerrë vendime.

Neni 161

Propozimin për shpalljen e referendumit komunal mund ta parashtrojë kryetari i Komunës, së paku një e treta e këshilltarëve dhe 5% e votuesve të regjistruar në listën e zgjedhësve të Komunës, sipas të dhënave për numrin e zgjedhësve nga zgjedhjet e fundit.

Neni 162

Referendumi vendor mund të shpallet me qëllim të deklarimit paraprak të qytetarëve për çështje me interes të drejtpërdrejtë për qytetarët nga rajoni i Komunës për të cilin shpallet referendumi, e sidomos :

- për futjen e vetëkontributit lokal;
- për ndërtimin e objekteve të infrastrukturës me interes për atë zonë;
- për çështjet me rëndësi për përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit;
- për çështje të tjera me rëndësi të veçantë për qytetarët e asaj zonë për të cilat Kuvendi i Komunës nxjerr vendime.

Neni 163

Propozimin për shpalljen e referendumit lokal mund ta parashtrojë kryetari i Komunës, së paku një e treta e këshilltarëve dhe 20% e votuesve të regjistruar në listën e zgjedhësve të Komunës për zonën në të cilën mbahet referendumi vendor, sipas të dhënave për numrin e zgjedhësve nga zgjedhjet e fundit të regjistruara për atë zonë.

Neni 164

Vendimin për shpalljen e referendumit e nxjerr Kuvendi i Komunës në pajtim me ligjin.

Procedura për mbajtjen e referendumit do të bëhet në pajtim me ligjin, me këtë Statut dhe vendimin për shpalljen e tij.

Format e tjera të pjesëmarrjes së qytetarëve

Neni 165

Qytetarët mund të marrin pjesë në arritjen e vetëqeverisjes lokale nëpërmjet peticioneve, propozimeve dhe ankesave.

Qytetarët kanë të drejtë t'u parashirojnë peticione, propozime dhe ankesa organeve të vetëqeverisjes lokale, si dhe të kërkojnë nga organet informacion për punën nga kompetencat e tyre.

Peticioni, propozimi ose ankesa i dorëzohet Kuvendit të Komunës ose kryetarit të Komunës, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në formë elektronike, me të dhënat për parashtruesin dhe adresën e tij.

Neni 166

Organi të cilit i dërgohet peticioni, propozimi ose ankesa është i detyruar ta shqyrtojë atë dhe të marrë vendim apo në rast të jokompetencës t'ia përcjellë atë organit kompetent, për të cilën gjë është i detyruar ta informojë parashtruesin.

Organi kompetent është i detyruar të marrë vendim, përkatësisht të jap njoftim në afat më të shkurtër, por jo më gjatë se 30 ditë dhe për këtë me shkrim të informojë parashtruesin dhe organin e Komunës të cilit direkt i është drejtuar propozimi, peticioni apo ankesa.

Neni 167

Me qëllim të pjesëmarrjes së popullatës lokale në marrjen e vendimeve me interes të drejtpërdrejtë dhe të përbashkët, Kuvendi, me vendim të veçantë, rregullon mënyrën dhe procedurën për pjesëmarrjen e popullatës në kryerjen e punëve publike.

Me vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni rregullohen: format (anketimet, mediat, planet, tabelat për njoftime, kutitë e vërejtjeve, propozimet dhe sugjerimet, faqet e internetit, telefonat kujdestarë, organizimi i punëtorive në bashkësitë lokale, pritja e ligjërueseve, takimet e ekspertëve dhe tryezat e rumbullakëta etj.), subjektet, procedurat, afatet dhe mënyrat e pjesëmarrjes së popullatës lokale në kryerjen e punëve publike, raporti për suksesin e procedurës dhe çështje të tjera me rëndësi për aktivitetet e popullatës lokale në nxjerrjen e vendimeve.

Neni 168

Për nxjerrjen e Statutit, planeve zhvillimore të Komunës, projektet urbanistike, buxhetit dhe akteve të përgjithshme që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, realizohet shqyrtimi publik.

Shqyrtimi publik realizohet edhe me rastin e akteve të tjera me të cilat vendoset për të drejtat dhe obligimet, si dhe për çështjet me rëndësi për popullatën lokale, në përputhje me vendimin e posaçëm të Kuvendit.

Shqyrtimi publik nuk mund të zgjasë më shkurt se 15 ditë.

IX - MARRËDHËNIET DHE BASHKËPUNIMI

Marrëdhënia e organeve të komunës dhe qytetarëve

Neni 169

Organet e komunës janë të detyruara të sigurojnë realizimin e të drejtave dhe obligimeve të popullatës lokale në mënyrë të ligjshme dhe efikase me respektimin e personalitetit e dinjitetit të qytetarit.

Funksionarët, nëpunësit dhe zyrtarët lokalë janë të detyruar të zbatojnë dispozitat e Kodeve Etike.

Për sjelljen në çështjet administrative, organet e administratës lokale janë të detyruar të theksojnë publikisht standardet e procedurës në pajtim me ligjin dhe vendimin me të cilin rregullohet organizimi dhe puna e organeve të administratës lokale dhe shërbimeve publike.

Neni 170

Organet e vetëqeverisjes lokale janë të detyruara që qytetarëve në realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre t'u japin të dhënat, njoftime dhe shpjegime të nevojshme.

Dhënia e njoftimeve realizohet edhe përmes rrugës së mjeteve teknike, broshurave dhe mediave.

Neni 171

Funksionarët lokalë dhe eprorët e organeve të administratës lokale janë të detyruar të përcaktojnë kohën e pranimit të qytetarëve.

Në objektet ku ndodhen organet e vetëqeverisjes lokale, organet e administratës lokale, shërbimet profesionale, shërbimet e posaçme dhe publike duhet të jetë i vendosur emri i organit, përkatësisht shërbimit.

Në vendë të dukshëm në hapësirat e organit përkatësisht shërbimit nga paragrafi 2 i këtij neni, duhet të figurojë renditja e hapësirave zyrtare.

Në hyrje të hapësirave zyrtare duhet të figurojë emri personal dhe titulli, përkatësisht profesioni i nëpunësit dhe zyrtarit lokal, përkatësisht të punësuarit tjetër.

Neni 172

Organet e administratës lokale dhe shërbimet e posaçme janë të detyruara të sigurojnë librin e përshtypjeve dhe kutinë për vërejtje dhe parashtrësia dhe pranimet tek personi që drejton ato organe dhe shërbime, me qëllim të komunikimit të vërejtjeve ose ankesave në punën e organeve, përkatësisht shërbimeve ose në marrëdhënien e parregullt të nëpunësit.

Në vërejtjet e parashtruara organet, përkatësisht shërbimet nga paragrafi 1 i këtij neni, janë të detyruara të përgjigjen me shkrim, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vërejtjes ose kundërshtimit, nëse qytetari e kërkon atë.

Organet dhe shërbimet nga paragrafi 1 i këtij neni, detyrimisht një herë në muaj, analizojnë ankesat, propozimet dhe parashtrësat e qytetarëve dhe marrin masa për zgjidhjen e problemeve për të cilat drejtohen qytetarët.

Neni 173

Për kryerjen e punëve të caktuara nga kompetencat e organeve të administratës lokale, veçanërisht në raport me realizimin e të drejtave të qytetarëve, organet e administratës lokale mund të organizojnë punën në bashkësitë lokale.

Punët nga paragrafi 1 i këtij neni, mënyra dhe vendi i kryerjes së tyre i përcakton kryeadministratori. Për mënyrën e kryerjes së punëve nga paragrafi 2 i këtij neni, qytetarët duhet të jenë të njoftuar publikisht.

Marrëdhëniet e organeve të komunës me organizatat joqeveritare

Neni 174

Me qëllim të afirmimit të një shoqëri të hapur dhe demokratike, organet e vetëqeverisjes lokale, organet e administratës lokale dhe shërbimet publike bashkëpunojnë me organizatat joqeveritare.

Me qëllim të realizimit të bashkëpunimit të përcaktuar me ligj, organet e Komunës do të sigurojnë që projektet dhe propozimet e akteve të përgjithshme, planeve dhe programeve të zhvillimit të dhe raporteve për punën e organeve të administratës lokale dhe shërbimeve publike në kohë t'u bëhen të arritshme organizatave joqeveritare përmes faqes së internetit të Komunës, me shikimin e materialit të organi kompetent dhe në mënyra të tjera të përcaktuara me vendim të posaçëm të Kuvendit.

Me qëllim të institucionalizimit të bashkëpunimit të organeve komunale dhe organizatave joqeveritare, Kuvendi i Komunës do të formojë Këshillin për bashkëpunim me

organizatat joqeveritare me qëllim të avancimit dhe realizimit të bashkëpunimit të Komunës dhe sektorit joqeveritar.

Neni 175

Përveç formës së bashkëpunimit të përcaktuar me ligj, kryetari i Kuvendit të Komunës do t'u mundësojë përfaqësuesve të organizatave joqeveritare të marrin pjesë në punën e Kuvendit për një çështje të caktuar për të cilën organizatat joqeveritare tregojnë interes, pa të drejtë vendimmarrjeje ("kërriga e zbrazët ").

Neni 176

Kryetari i Kuvendit të Komunës sipas nevojës, e së paku një herë në vit, do të organizojë takim me përfaqësuesit e organizatave joqeveritare me qëllim të avancimit të punës dhe bashkëpunimit të përbashkët.

Kryetari i Komunës sipas nevojës, e së paku një herë në vit, do të organizojë takim pune me përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, me qëllim të shqyrtimit të bashkëpunimit dhe deritashëm dhe mundësitë për avancimin e tij.

Marrëdhëniet e organeve të Komunës dhe organeve shtetërore, organeve të administratës shtetërore, shërbimeve publike themelues i të cilave është shteti dhe Qeveria

Neni 177

Dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale me të cilat rregullohen çështjet e marrëdhënieve ndërmjet organeve të vetëqeverisjes lokale dhe shërbimeve publike, marrëdhëniet ndërmjet organeve të vetëqeverisjes lokale, organeve shtetërore, dhe organeve të administratës shtetërore, marrëdhëniet ndërmjet organeve të vetëqeverisjes lokale dhe Qeverisë zbatohen drejtpërdrejt.

Bashkëpunimi ndërkomunal

Neni 178

Komuna bashkëpunon me qytete dhe komuna të tjera brenda dhe jashtë vendit në fushat me interes të përbashkët në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin.

Vendimin për bashkëpunim nga paragrafi 1 i këtij neni e sjell Kuvendi.

Bashkëpunimi ndërkufitar

Neni 179

Si komunë kufitare Komuna e Ulqinit realizon bashkëpunim të veçantë me komunat e tjera në vend dhe jashtë vendit në rajonin kufitar, me qëllim promovimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe rritjen e zhvillimit shoqëroro-ekonomik përmes iniciativave të përbashkëta lokale dhe rajonale. Bashkëpunimi zhvillohet në pajtim me Kushtetutë, ligj dhe marrëveshjet në mes të Malit të Zi dhe Komisionit Evropian dhe formave të tjera të bashkëpunimit në kornizën e politikës së Bashkimit Evropian, e gjitha me qëllim thithjen e mjeteve dhe rritjen e investimeve në fusha të ndryshme nga instrumentet mbështetëse dhe fondet e tjera evropiane.

Kuvendi i komunës mundë të themelojë forume dhe trupa të tjera me qëllim të mbikëqyrjes së aktiviteteve nga paragrafi i mësipërm.

X - PUNA E HAPUR DHE TRANSPARENCA

Neni 180

Puna e hapur dhe transparencë e organeve të vetëqeverisjes lokale, organeve të administratës lokale dhe shërbimeve publike sigurohet në përputhje me ligjin.

Përveç mënyrës së përcaktuar me ligj, puna e hapur dhe transparencë e organeve të vetëqeverisjes lokale, organeve të administratës lokale dhe shërbimeve publike sigurohet:

- me qasje të lirë në informata në pajtim me ligjin;
 - me informimin e publikut për punën e organeve, aktivitetet që janë në vijim dhe planet për periudhën e ardhshme;
 - me publikimin e akteve të përgjithshme dhe akteve të tjera në Gazetën Zyrtare të Malit të Zi dhe në faqen e internetit të Komunës;
 - me publikimin e raporteve të organeve të komunës dhe të shërbimeve publike në mjetet e informimit publik ose në mënyrë tjetër të përshtatshme;
 - me publikimin e informatorit për punën e organeve i cili përmban informata që janë interes të drejtpërdrejtë për qytetarët;
 - me publikimin e vendimeve në faqen e internetit të Komunës të vendimeve për ndarjen e punëve dhe shërbimeve dhe kontratave të lidhura me personat juridikë e fizikë, si dhe vendimet individuale dhe aktet tjera dhe kontratat e lidhura në procedurën e disponimit të pronës së Komunës;
 - me publikimin në faqen e internetit të pagave dhe të ardhurave të tjera të funksionarëve lokalë të Komunës, si dhe urdhrave të udhëtimit të funksionarëve, nëpunësve dhe zyrtarëve lokalë;
 - me shikimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve në akte dhe dokumente të tjera zyrtare që kanë të bëjnë me realizimin e funksioneve të Komunës dhe realizimin e të drejtave të qytetarëve
 - pjesëmarrja e qytetarëve në shqyrtimin publik në procesin e nxjerrjes së vendimeve dhe akteve të tjera që rregullojnë çështjet me interes të drejtpërdrejtë për qytetarët
 - me organizimin e formave të ndryshme të edukimit të qytetarëve etj.
- Mënyra dhe procedura për realizimin e publikut dhe transparencës më për së afërmi rregullohen me Rregulloren e punës së Kuvendit dhe vendimet e Kuvendit.

Neni 181

Me qëllim të sigurimit të punës së hapur dhe transparencës së organeve të Komunës dhe të shërbimeve publike, kryetari i Komunës, kryetari i Kuvendit dhe kryeadministratori janë të detyruar së paku një herë në tre muaj nëpërmjet medias lokale, ose në një mënyrë tjetër të përshtatshme, të informojnë qytetarët, për aktivitetet e organeve për aktivitetet në të kaluarën dhe ato të planifikuara në periudhën e ardhshme.

Organet e administratës lokale dhe të shërbimit publik janë të detyruara të njoftojnë publikun për kryerjen e punëve nga fushëveprimi i vet nëpërmjet medias ose në një mënyrë tjetër të përshtatshme dhe të raportojnë për punën e tyre dhe për aktivitetet e planifikuara.

Neni 182

Organet e administratës lokale janë të detyruara të njoftojnë publikun për vlerësimin e analizës së ndikimit të vendimeve dhe dispozitave të tjera (RIA) të cilat i nxjerr Kuvendi dhe kryetari i Komunës, në mënyrën dhe me procedurën e përcaktuar në Statut.

Në procesin e nxjerrjes ose ndryshimit të vendimeve, dispozitave dhe akteve të tjera, organi është i detyruar të përgatisë një analizë të ndikimit të këtij akti në qytetarët dhe subjektet e tjera në të cilat aktet zbatohen drejtpërdrejt.

Analiza e ndikimit përmban vlerësimin e ndikimit financiar, ndikimin në kohëzgjatjen e procedurave dhe afatet, përfitimet që sjellë dispozita për qytetarët, bizneset dhe komunitetin në tërësi.

Me draftin e aktit miratimin e të cilit e planifikon propozuesi i aktit është i detyruar t'i bashkëngjisë Analizën e ndikimit të dispozitave në buxhet, qytetarët dhe komunitetin e biznesit, dhe si të tillë, ta bëjë pjesë integrale të aktit.

Kur bëhet ndryshimi i një dispozite të veçantë, RIA analiza përmban pasqyrën e ndikimit të zgjidhjeve ekzistuese dhe pasqyrën krahasuese të ndikimit të dispozitës së ndryshuar e cila propozohet.

Në procedurën e shqyrtimit publik për dispozitat për të cilat është i detyruar shqyrtimi publik, pjesë përbërëse e aktit për të cilin mbahet shqyrtimi publik është edhe analiza RIA.

XI - FORUMI PËR ZHVILLIMIN DHE MBROJTJEN E VETËQEVERISJES LOKALE

Neni 183

Kuvendi themelon Forumin për Zhvillimin dhe Mbrojtjen e Vetëqeverisjes lokale me qëllim të avancimit të punës së vetëqeverisjes lokale.

Forumit për Zhvillimin dhe Mbrojtjen e Vetëqeverisjes lokale ka kryetarin dhe 4 anëtarë, të cilët zgjidhen nga radha e qytetarëve të shquar të Komunës dhe ekspertëve në fushat me rëndësi për vetëqeverisjen lokale.

Neni 184

Për anëtarë të Forumit nuk mund të zgjidhen:

- deputetët dhe këshilltarët;
- funksionarët lokalë, eprorët e organeve të administratës lokale dhe udhëheqësit e shërbimeve publike themelues i të cilave është Komuna;
- personat e zgjedhur, emëruar dhe vendosur në Qeverinë e Malit të Zi dhe organet e administratës shtetërore;
- funksionarët e partive politike (kryetarët e partive, anëtarët e kryesisë, zëvendësit e tyre, anëtarët e këshillave ekzekutive dhe kryesore dhe funksionarët e tjerë të partisë);
- personat të cilët janë të dënuar për vepër penale me aktgjykim të formës së prerë kundër detyrës zyrtare, vepër penale të korrupsionit, mashtrimit ose vjedhjes, pa marrë parasysh dënimin e shqiptuar, apo janë të dënuar me burg në kohëzgjatje më shumë se 6 (gjashtë) muaj me vendim të formës së prerë.

Neni 185

Forumit ka të drejtë që organeve shtetërore, organeve të vetëqeverisjes lokale dhe shërbimeve publike t'u parashtrojë propozime për avancimin dhe zhvillimin e vetëqeverisjes lokale, ngritjen e nivelit të cilësisë së shërbimeve publike, mbrojtjen e përcaktuar me Kushtetutë dhe ligj të të drejtave dhe detyrave të Komunës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të popullatës vendore.

Në kryerjen e funksionit të tij, Forumit ka të drejtë që nga organet shtetërore, organet e Komunës dhe shërbimet publike themelues i të cilave është Komuna, të kërkojë informata për çështjet nga kompetencat e tyre.

Organet dhe shërbimet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni janë të obliguar të deklarohen për kërkesat dhe propozimet e Forumit në një afat të arsyeshëm, e më së gjati në afat prej 60 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës, propozimit.

Neni 186

Mënyra e zgjedhjes dhe puna e Forumit dhe çështje të tjera të rëndësishme për punën e tij më për së afërmi rregullohen me vendimin për themelimin e tij.

XII - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 187

Procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit niset me propozimin e vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit.

Propozimi nga paragrafi 1 i këtij neni mund të parashtrohet nga të paktën një e treta e këshilltarëve, kryetari i Komunës dhe të paktën 5% e votuesve të regjistruar në regjistrin zgjedhor të Komunës, sipas të dhënave për numrin e zgjedhësve nga zgjedhjet e fundit.

Neni 188

Aktet e përgjithshme, nxjerrja e të cilave është parashikuar me këtë Statut, do të nxirren në afat prej 90 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij Statuti.

Deri në nxjerrjen e akteve nga paragrafi 1 i këtij neni, do të zbatohen aktet ekzistuese nëse nuk janë në kundërshtim me këtë Statut.

Neni 189

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti, pushon së qeni i vlefshëm Statuti i Komunës së Ulqinit i publikuar në ("Gazetën Zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës", nr. 5/07, 9/09 dhe 16/11).

Neni 190

Ky Statut hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës".

Numër: 02 – 238/19-2

Ulqin, 28.10.2019

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Kryetari,

Dr. Ilir Çapuni, d.v.